



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 226 Akti

Nr. 219 Vendimi

Tiranë, më 10.12.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja

Kryesues

Firdes Shuli

Relatore

Roland Ilia

Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Mia Roessing, në datat 5.12.2019 dhe 10.12.2019, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Genti Xholi**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Nenet 179/b, A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, të ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relativin dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Firdes Shuli, mori në shqyrtim shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Genti Xholi, proces i cili ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve: të pasurisë; të figurës; dhe të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, dhe në përfundim, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Genti Xholi, është subjekti i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror. Në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), të gjithë prokurorët i nënshtrohen rivlerësimit, *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Genti Xholi, ushtron funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, që prej vitit 2010 dhe aktualisht. Më herët, që prej vitit 2000 ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Me shkresën nr. *** prot., datë 30.4.2018, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me nr. *** prot., datë 25.5.2018, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Genti Xholi.

4. Me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, protokolluar në Komisionin, me nr. *** prot., datë 11.10.2019, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), ka vënë në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës të deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***, datë 4.10.2019, të KDZH-së.

5. Me shkresën nr. *** prot., datë 11.10.2019, protokolluar në Komisionin, me nr. *** prot., datë 31.10.2019, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), ka vënë në dispozicion raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Genti Xholi.

6. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit” Komisioni, ka zhvilluar shortin në datën 15.11.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Genti Xholi, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Etleda Çiftja dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.

7. Trupi gjykues, gjatë procesit të rivlerësimit, administroi:

7.1 Aktin për vlerësimin e pasurisë, sipas neneve 31 – 33, të ligjit nr. 84/2016, përpiluar nga ILDKPKI-ja.

7.2 Raportin e vlerësimit të figurës, sipas neneve 34 – 39, të ligjit nr. 84/2016, përpiluar nga DSIK-ja.

7.3 Raportin e vlerësimit profesional, sipas neneve 40 – 44, të ligjit nr. 84/2016, përpiluar nga KLP-ja.

8. Me vendimin e datës 26.11.2018, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Genti Xholi, duke përfshirë të tria kriteret: të pasurisë, të figurës, dhe të aftësive profesionale, si dhe caktoi në cilësinë kryesuesit të trupit

gjykues, komisioneren Etleda Çiftja. Në mbledhjen e kësaj date, të gjithë anëtarët e trupit gjykues deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

9. Në datën 18.1.2019, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike fillimi i procedurave të rivlerësimit, si dhe iu njoftua përbërja e trupi gjykues, për të cilin në datën 22.1.2019, subjekti deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me asnjë prej anëtareve të tij.

10. Me vendimin nr. 2, datë 07.11.2019, trupi gjykues vendosi:

10.1. Të përfundojë hetimin administrativ për të tria kriteret e parashikuara në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016;

10.2. Të miratojë rezultatet e hetimit administrativ;

10.3. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit se provat e grumbulluara lidhur me vlerësimin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, duke i kaluar barrën e provës mbi rezultatet e hetimit kryesisht, për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, sipas parashikimeve të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016.

10.4. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për të drejtat në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe nenet 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

11. Në datën 24.11.2019, subjekti vuri në dispozicion në rrugë elektronike, parashitë të sqarimeve, si dhe e dokumente shkresore bashkëngjitur.

12. Në datën 5.12.2019 u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Genti Xholi, sipas nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

13. Në datën 10.12.2019, trupi gjykues, pasi vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit, deklaroi të mbyllur seancën dëgjimore, dhe bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit, dhe vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”*, si dhe bazuar në pikën 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, shpalli vendimin për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Genti Xholi.

II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

II.1 VLERËSIMI I PASURISË

II.1.a Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Nga aktet e vëna në dispozicion nga ILDKPKI-ja rezulton se:

Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private për vitet 2003 - 2017, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*.

Në datën 25.1.2017 subjekti ka dorëzuar deklaratën e pasurisë *“Vetting”* në ILDKPKI, në përputhje me nenin 32/1, të ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*.

ILDKPKI-ja, ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur, sipas neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016, dhe me aktin me nr. ***prot., datë 30.4.2018, ka konkluduar se:

deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;

ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;

nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
nuk ka kryer deklaram të remë;
subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

II.1.b Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Megjithëse, sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2/2017^[1] dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, ka realizuar një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Lidhur me pasuritë e subjektit të rivlerësimit, z. Genti Xholi, është kryer një proces i plotë hetimi administrativ, sipas dispozitave ligjore të kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në : (i) deklaramet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49, të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin sipas nenit 46, të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi administrativ, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarameve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur me të; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin ose jo të deklarameve të rreme; dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin, nëse subjekti ka bërë deklaramet të pamjaftueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Hetimi administrativ nga Komisioni, sipas neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84 /2016, është kryer në lidhje me pasuritë e deklaruara në deklaramtën “Vetting”, si vijon:

Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit:

1. Autoveturë e markës “Volkswagen”, tip Passat, me targa ***, blerë sipas kontratës nr. ***, datë 24.11.2015, me burim: të ardhurat nga “Fondi Prestigj - Raiffeisen Bank”, në euro dhe në lekë, tërhuqur në datën 17.11.2015, përkatësisht vlera 2.060,25 në euro dhe vlera 469.017,52 në lekë, si dhe pjesa *cash* e mbetur nga kredia e marrë në “Raiffeisen Bank” në vitin 2013. Vlera e pasurisë: 6.000 euro. Pjesa takuese: 100 %.

^[1] “41.Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

Gjatë hetimit administrativ, DPSHTRR-ja¹ konfirmoi pronësinë e z. Genti B. Xholi, mbi automjetin e markës “Volkswagen Passat”, me targa ***, blerë me kontratën e shitjes së datës 24.11.2015, nga shtetasi B. S., në shumën 6.000 euro, likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale.

1.1 Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit rezultoi se:

- Në deklarinimin për vitin 2015, subjekti ka deklaruar: “Autoveturë e markës Volkswagen, tipi Passat, targa ***, blerë sipas kontratës së datës 24.11.2015, me të ardhurat nga Fondi Prestigj – Raiffeisen Bank, në euro dhe në lekë, të cilat u tërhoqën në datën 17.11.2015, respektivisht shumën 2,060.25 në euro dhe shumën 469.017.52 në lekë dhe pjesa cash e mbetur nga kredia e mëparshme, deklaruar në vitin 2014. Vlera: 6.000 euro. Pjesa takuese: 100 %”.

- Në deklaratën “Vetting”, mjeti është deklaruar me të njëjta deklarime.

Nuk u konstatuan mospërputhje dhe pasaktësi në deklarime.

1.2 Në lidhje me burimin e krijimit:

Si burim për krijimin e kësaj pasurie janë deklaruar:

1.2.a Të ardhurat nga “Fondi Prestigj – Raiffeisen Bank”, në euro dhe në lekë, të cilat u tërhoqën në datën 17.11.2015, përkatësisht në shumën 2.060.25 dhe në shumën 469.017,52 lekë.

Në lidhje me këtë burim, nga verifikimi në “Raiffeisen Bank”², gjatë hetimit administrativ rezultoi se:

i) në datën 20.11.2015, llogaria me nr. ***, në “Raiffeisen Bank”, në emër të bashkëshortes së subjektit, znj. N. Xh., është kredituar në shumën 465.281 lekë nga shlyerja e fondit të “Raiffeisen Invest”;

ii) në datën 23.11.2015, shuma 461.000 lekë, është konvertuar në 3.377 euro;

iii) po në datën 23.11.2015, llogaria me nr. ***, në “Raiffeisen Bank” e znj. N. Xh., është kredituar në shumën 2.041 euro, nga shlyerja e fondit të “Raiffeisen Invest”;

iv) në datat 24.11.2015 dhe 25.11.2015, znj. N. Xh., ka tërhequr nga llogaria në euro përkatësisht shumat 3.500 euro dhe 1.900 euro, pra, në total 5.400 euro, të cilat deklaroi se i ka përdorur për blerjen e automjetit.

Për sa më sipër, vihet re se deklarinimet e subjektit përputhen me veprimet bankare. Gjatë analizës financiare, është vërtetuar se kjo llogari është me të ardhura të ligjshme.

1.2.b Pjesa cash e mbetur nga kredia e marrë në “Raiffeisen Bank” në vitin 2013.

Lidhur me këtë burim, nga verifikimi gjatë hetimit administrativ, rezultoi se:

i) Në datën 1.3.2013, bashkëshortes së subjektit, znj. N. Xh., i është disbursuar nga “Raiffeisen Bank”³ kredia në shumën 1.000.000 lekë, për qëllim personal, shumë e vërtetuar që është tërhequr e gjitha në data të ndryshme.

ii) Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, bashkëshortja e subjektit, znj. N. Xh., ka deklaruar kredi me afat 1.3.2013 - 1.3.2020, marrë nga “Raiffeisen Bank”, si dhe gjendje cash nga pjesa e papërdorur e kredisë, në shumën 500.000 lekë.

¹ Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. ***prot., datë 24.1.2019, dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. ***prot., datë 6.2.2019 nga DPSHTRR-ja, në dosjen e Komisionit.

² Shihni shkresën nr. ***prot., datë 25.1.2019, nga “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

³ Shihni shkresën nr. ***prot., datë 25.1.2019 nga “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

iii) Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, bashkëshortja e subjektit, znj. N. Xh., ka deklaruar gjendje *cash* shumën prej 150.000 lekësh, pjesë e papërdorur e kredisë, shumë e cila është përdorur për blerjen e automjetit.

iv) Gjatë procesit të rivlerësimit, pasi është pyetur lidhur me përdorimin e kredisë prej 1.000.000 lekësh, subjekti ka sqaruar se⁴: ... *kjo kredi është marrë me interes të ulët nga bashkëshortja e tij si punonjëse në Raiffeisen Bank, dy javë pas marrjes së një kredie të mëparshme në shumën 300.000 lekë. Kjo kredi është përdorur ndër vite si vijon:*

- *në vitin 2013 rreth 180.000 lekë për blerje të makinës Renault Megane; rreth 200.000 lekë për shpenzimet e udhëtimit familjar në Itali; rreth 165.000 lekë blerje elektroshtëpiake në banesën në rrugën ***; rreth 450.000 lekë janë mbajtur cash për tu përdorur më vonë, pjesë e deklaruar cash në vitin 2013 në masën 500.000 lekë.*

- *në vitin 2014, një pjesë e gjendjes cash të vitit 2013 është përdorur për të mbyllur overdarftin në Credins Bank me limit në vlerën 300.000 lekë; pjesa tjetër, vlera 150.000 lekë është mbajtur cash, e deklaruar po atë vit.*

- *në vitin 2015 – pjesa e mbajtur cash në vitin 2014 është përdorur për të plotësuar shumën e nevojshme për blerjen e automjetit Volkswagen, Passat, me targë ***.*

Për sa më sipër, në lidhje burimin “pjesa cash e mbetur nga kredia e marrë në vitin 2013”, rezultoi se deklarimet e subjektit kanë qenë të sakta dhe përpunet me dokumentet e administruara.

1.3 Në lidhje me mundësinë financiare për blerjen e pasurisë:

Nga analiza financiare për vitin 2015 (mjeti është blerë më 24.11.2015), pasqyruar si në tabelën më poshtë, rezulton se subjekti ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për të blerë automjetin.

	Përshkrimi	2015
1	PASURI	667.671
	Automjet Vokswagen Passat, ***	825.900
	Pakësime likuiditete	-158.229
2	DETYRIME	50.636
	Kredi “Raiffeisen Bank”	987.426
	Shlyerje principal kredi	-158.370
3	PASURI NETO (1-2)	617.035
4	TË ARDHURA	2.687.791
	Të ardhura nga paga subjekti	1.213.619
	Të ardhura nga paga bashkëshortja	1.338.218
	Të ardhura nga interesa bankare	135.954
5	SHPENZIME	1.163.513
	Shpenzime me kartë krediti	119.338
	Shpenzime interesa kredie	34.903
	Shpenzime jetese ILDKPKI	897.104
	Shpenzime udhëtimi	112.168
	DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 4-3-5)	907.243

⁴ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 dërguar nga subjekti në rrugë elektronike, në datën 30.9.2019, në dosjen e Komisionit.

Nga analiza financiare rezulton e vërtetuar se, shuma *cash* prej 150.000 lekësh e deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, ka si burim kredinë prej 1.000.000 lekësh. Deklarimet e subjektit, në lidhje me shpenzimet me të ardhura të përfituara nga kredia, janë përfshirë në analizën financiare.

2. Deklaratë noteriale nr. ***, datë 25.2.2015, me anë të të cilës në pozitën e trashëgimtarëve ligjorë të I. Sh., është rënë dakord me planin e rievimit përkatës të pasurisë së ndodhur në z.k. ***, pasuria nr. ***, në Rr. “****”. Ky akt u përpilua për të proceduar më pas me regjistrimin e kësaj prone në hipotekë, për të cilin është bërë aplikimi përkatës, por akoma nuk është marrë përgjigje nga institucioni.

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se, në momentin e plotësimit të deklaratës “Vetting” subjekti nuk e ka pasur as në pronësi dhe as në përdorim pasurinë me adresën e sipërpërmendur, dhe aktualisht, kjo pasuri është në proces regjistrimi në emër të bashkëpronarëve, njëri prej të cilëve është edhe subjekti i rivlerësimit.

2.1 Nga deklaratimet e subjektit lidhur me këtë pasuri është konstatuar se:

- Subjekti e ka deklaruar rregullisht këtë pasuri si adrese banimi dhe adresë të gjendjes civile, në deklaratat periodike vjetore për vitet 2003–2016.

- Në deklaratat periodike vjetore të viteve 2010, 2013 dhe 2015, subjekti ka dhënë deklarime të hollësishme lidhur me këtë pasuri, duke përmendur dokumente trashëgimie, të cilat i vuri në dispozicion të Komisionit⁵, menjëherë pasi iu kërkuan gjatë hetimit administrativ.

- Në përgjigjet e pyetësorit të parë standard, subjekti ka deklaruar se është bashkëpronar i pasurisë së paluajtshme nr. ***, nr. ***, ndodhur në Rr. “****”, së bashku me shtetasit P. A. (tezja e subjektit) dhe Xh. Sh. (daja i subjektit). Kjo pasuri është e regjistruar në hipotekë në emër të gjyshit të subjektit, z. I. Sh. dhe se aktualisht, për probleme hipotekore është bërë e pamundur marrja e një certifikate pronësie.

2.2 Me qëllim verifikimin e origjinës së pasurisë dhe mosmarrëveshjeve të mundshme midis bashkëpronarëve apo të tretëve, statusin juridik, përdorimin dhe investimet e mundshme nga subjekti mbi këtë pasuri, janë kryer veprimet hetimore, si vijojnë:

2.2.a Në lidhje me origjinën dhe statusin juridik të pasurisë:

Nga përgjigjet e pyetësorit të dytë dhe dokumentet bashkëngjitur, si dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion prej Agjencisë Shtetërore të Kadastrës⁶, u vërtetua se në rend kronologjik në lidhje me këtë pasuri janë kryer veprimet, si vijojnë:

- Me aktin vërtetues që mban datën 15.12.’59 vërtetohet se në regjistrin e zyrës së hipotekës Tiranë, figuron e transkriptuar në emër të z. Xh. Sh. (stërgjyshi i subjektit), biri i të ndjerit I., në lagjen “****”, Tiranë, një shtëpi dykatëshe, me oborr përpara dhe mbrapa e blerë prej z. R. K., me çmimin prej 12.000 franga ari.

- Me kontratën “pjesëtim shtëpiash”, në datën 02.II.1960, z. I. Sh. (gjyshi i subjektit), se bashku me të dy vëllezërit Q. Sh. dhe F. Sh., dhe me nënën e tij Gj. Sh., marrin si pjesë të tyre shtëpinë e ndodhur në Tiranë, ish-lagjja “****”, Rr. “****”, nr. ***.

- Sipas dokumentit “të dhënat e pasurisë” rezulton se pasuria me nr. regjistri ***, nr. rendor 283, datë 24.10.1962, të ZVRPP-së Tiranë, është e regjistruar në emër të z. I. Xh. Sh..

⁵ Shihni dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, dërguar nga subjekti në rrugë elektronike në datën 30.9.2019, në dosjen e Komisionit.

⁶ Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. ***prot, datë 8.10.2019, nga ASHK Tirana Veri; shkresë kthim përgjigjeje nr. ***prot., datë 22.10.2019, dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.9.2019, nga ASHK Tirana Veri, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

- Me vendimin nr. ***, datë 13.4.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt lëshim i dëshmisë së trashëgimisë (me kërkesë të z. Genti Xholi), për trashëgimlënësit I. Sh. dhe F. Sh. (Xholi) (përkatësisht gjyshi dhe nëna e subjektit), subjekti është përcaktuar si njëri nga trashëgimtarët ligjorë të znj. F. Sh. (Xholi). Sipas këtij vendimi, S. Sh. (bashkëshortja), Xh. Sh. (i biri), P. Sh. A. (e bija) dhe nëna e subjektit, znj. F. Sh. (Xholi) (e bija), kanë përfituar nga ¼ pjesë secili të të gjithë pasurisë trashëgimore të shtetasit I. Sh.. Duke qenë se znj. F. Sh. (Xholi) ka ndërruar jetë, trashëgimtarët e saj janë: B. Xh. (bashkëshorti) dhe Genti Xholi (i biri), të cilët përfitojnë ½ pjesë të gjithë pasurisë.

- Me aktin vullnetar për heqjen dorë nga e drejta e pronësisë në dobi të një të treti, nr. ***, datë 5.12.2011, z. B. Xh., babai i subjektit, ka hequr dorë nga e drejta e bashkëpronësisë për të gjitha pronat e trashëgimlënësës së tij znj. F. Sh. (Xholi) (bashkëshortja e tij dhe nëna e subjektit), e drejtë që buron nga vendimi i mësipërm i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke e kaluar në favor të djalit të tij, z. Genti Xholi (¼ pjesa e tij).

- Me dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. ***, datë 6.12.2013, me objekt lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësës S. Sh. (bashkëshortja e I. Sh., gjyshja e subjektit), u përcaktuan trashëgimtarët ligjorë të saj, të cilët janë: e bija P. A., i biri Xh. Sh. dhe nipi Genti B. Xholi, të cilët trashëgojnë në mënyrë të barabartë pasuritë e saj.

- Për pasurinë objekt shqyrtimi është përpiluar planrilevimi i datës 2.11.2015, për të cilin bashkëpronarët e pasurisë, Xh. Sh., P. A. dhe Genti Xholi, me deklaratën noteriale nr. ***, datë 25.12.2015, deklarojnë se janë plotësisht dakord me këtë planrilevimi, i cili përcakton pjesët takuese.

- Kjo pasuri, vijon të jetë e regjistruar në emër të ish-pronarit, z. I.Xh. Sh., gjyshi i subjektit të rivlerësimit. ASHK-ja Tiranë nuk konfirmoi bllokime të kësaj pasurie në zyrën e regjistrimit të pasurive.

2.2.b Nga subjekti i rivlerësimit, në lidhje me periudhën e përdorimit të pasurisë dhe me investimet mbi këtë pasuri, u konstatua se:

- Nga përmbajtja e deklaratave periodike, deklaratës “Vetting”, përgjigjeve të dhëna nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe nga provat e administruara, u vërtetua se subjekti ka jetuar në këtë banesë që nga lindja e tij e deri në maj 2016.

- OSHEE-ja⁷ nuk konfirmoi kontratë të furnizimit me energji në instancën e Tiranës në emër të subjektit Genti Xholi. Ndërkohë, OSHEE-ja ka konfirmuar⁸ në emër të shtetasit H.Sh., për të cilin subjekti sqaroi pasaktësinë në emër të abonentit që sipas tij, duhet të ishte I. Sh., pasaktësi e cila nuk ka mundur të korrigjohet nga familjarët⁹.

Referuar pagesave mujore të energjisë, u konstatua se, për këtë banesë ka pasur shpenzime të energjisë elektrike edhe pas muajit qershor 2016, kur subjekti është larguar prej saj, deri në muajin dhjetor 2018, të cilat variojnë nga 248.79 lekë – 4044.40 lekë, vlera më të ulëta krahasuar me vitet paraardhëse gjatë të cilave subjekti ka banuar në këtë banesë. Nisur nga ky informacion, u pyet subjekti në lidhje me përdorimin e banesës, pasi është larguar prej saj, si dhe në lidhje me investimet e kryera mbi këtë pasuri.

Në përgjigjet e datës 16.10.2019, subjekti ka sqaruar se *...pas largimit të tij, kjo banesë nuk është banuar nga askush, por një pjesë e saj, është shfrytëzuar nga daja i tij, i ndjeri Xh. Sh., si magazinë materiale dhe sendesh të tij, pas mbylljes gradualisht të aktivitetit të tij tregtar,*

⁷ Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. ***prot., datë 31.1.2019, nga OSHEE, në dosjen e Komisionit.

⁸ Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.2.2019, nga OSHEE-ja, në dosjen e Komisionit.

⁹ Shihni e-mail dërguar nga subjekti në datë 21.1.2019, në përgjigje të pyetësorit të I-rë, në dosjen e Komisionit.

*si administrator i shoqërisë “***” sh.p.k., pasi në vitin 2015 ishte diagnostikuar me një sëmundje të rëndë....*

Për të vërtetuar këtë pretendim, subjekti ka vënë në dispozicion ekstrakt të shoqërisë “****” sh.p.k., me status pezulluar, me adresë të regjistrimit, Njësia Nr. ***, sheshi “****” banesa nr. ***, Tiranë. Ndërkohë, nga verifikimi në faqen *on-line* të QKB-së, rezulton se, “****” sh.p.k. me administrator dhe ortak të vetëm z. Xh. Sh., ka pezulluar aktivitetin në datën 1.5.2017 dhe bilanci i fundit i dorëzuar në QKB është në vitin 2015.

Në lidhje me gjendjen aktuale të pasurisë dhe investime të kryera mbi të, subjekti ka deklaruar se: *aktualisht kjo banesë është në gjendje shumë të amortizuar, pasi ka qenë ndërtuar që në vitin 1930 dhe prej vitesh nuk është vënë dorë në të.... nga bashkëpronarët e tjerë iu kërkuar që të mos bënte shpenzime pasi ata kërkonin që banesa dhe trualli në fjalë të jepej për ndërtim. Për këtë arsye nga të gjithë bashkëpronarët u pa më e arsyeshme që kjo pasuri të jepej me qira ose për ndërtim. aktualisht janë në tratativa me disa shoqëri ndërtimi por akoma nuk është konkretizuar në akte konkrete...*

Subjekti, për të vërtetuar pretendimet e tij, vuri në dispozicion 37 (tridhjetë e shtatë) foto me ngjyra të ambienteve të ndryshme të banesës¹⁰, nga verifikimi i të cilave, duket se është e amortizuar. Nisur nga këto foto, si dhe referuar informacionit të OSHEE-së, sipas të cilit deri në dhjetor të vitit 2018, shpenzimet e energjisë kanë qenë në vlera më të vogla krahasuar me periudhën para se subjekti të largohej prej saj, Komisioni krijoi bindjen se mbi këtë pasuri nuk janë kryer investime.

Pretendimet e subjektit në lidhje me shkaqet e largimit nga banesa, vërtetohen edhe me deklaratën personale të shtetases P. A. (Sh.) të datës 22.11.2019¹¹, e cila si një prej bashkëpronareve të pasurisë, konfirmon deklaratimet e subjektit se pasuria në fjalë është kërkuar të shfrytëzohet në mënyrë të barabartë nga të tre bashkëpronarët. Sipas saj, që prej vitit 2015 dhe aktualisht, dy dhoma të kësaj shtëpie janë të zëna prej pajisjeve të aktivitetit të dajës së subjektit, të ndjerit Xh. Sh.

Bazuar në sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, për pasurinë objekt shqyrtimi, nuk rezultuan problematika, pasi në mënyrë të përmbledhur, u vërtetua se :

- i) pasuria e llojit truall me sip. 103 m² + ndërtesë me sip. 21 m², figuron e regjistruar në emër të shtetaset I. Xh. Sh., gjyshi i subjektit;
- ii) kjo pasuri është e papajisur me dokument pronësie dhe është e afishuar në emër të ish-pronarit, në pritje për t’u reregjistruar në emër të tre bashkëpronarëve, njëri prej të cilëve është dhe subjekti i rivlerësimit;
- iii) midis bashkëpronarëve, apo edhe me të tretë, nuk pati të dhëna dhe nuk u vërtetua të ketë pretendime apo ndonjë konflikt në lidhje me pronësinë apo ndarjen e pjesëve;
- iv) deklaratimet e subjektit ndër vite, në deklaratën “Vetting”, si dhe gjatë procesit të rivlerësimit përputhën me njëra-tjetrën dhe me informacionin e marrë nga dokumentet shkresore;
- v) nuk ka asnjë të dhënë dhe nuk vërtetohet që subjekti të ketë kryer investime mbi këtë pasuri;
- vi) nuk ka asnjë të dhënë dhe nuk u vërtetua ndonjë përfitim i padrejtë nga subjekti mbi këtë pasuri.

3. Apartament me sip. 103.46 m², adresa: lagjja nr. *, Rr. “****”, kati i ***, Pogradec, blerë sipas kontratës nr. ***, datë 10.9.2016. Shlyerja e shumës për kalimin e të drejtave mbi**

¹⁰ Shihni fotot bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit të datës 16.10.2019, në dosjen e Komisionit.

¹¹ Shihni dokumentet bashkëngjitur në parashtrimet e datës 24.11.2019, në dosjen e Komisionit.

apartamentin në fjalë, është bërë në vitin 2010 nga kursimet e mëparshme dhe me kredinë e marrë në shumën 1.000.000 lekë, me afat 23.12.2010 – 23.12.2012. Vlera: 4.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Në lidhje me këtë pasuri, gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:

- ASHK-ja Pogradec¹² informoi se në emër të subjektit figuron e regjistruar pasuria e llojit apartament me sip. totale 103.46 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, me indeks harte ***, me adresë: lagjja nr. ***, Rr. “****”, shk. ***, k. ***, ap. ***, z.k. ***, Pogradec.
- OSHEE-ja¹³ informoi se z. Genti Xholi është abonent me kod kontrate *** në instancën e Pogradecit, hapur në datën 30.6.2011.

3.1 Nga deklaratimet periodike, rezultoi se:

- Në deklarinimin për vitin 2010, është deklaruar: *“Në bazë të kontratës nr. ***, datë 11.12.2010 ‘kalim të drejtash’, më janë kaluar të drejtat që shtetasi A. B. kishte mbi apartamentin me sip. 103.46 m², adresa: lagjja nr. ***, Rr. “****”, Pogradec, kati i *** (të drejtat mbi apartamentin janë përfutur nga z. A. B. si pronar i truallit të ndërtimit, nga kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 23.11.2006). Shlyerja e shumës për kalimin e të drejtave mbi apartamentin në fjalë është bërë nga kursimet e mëparshme dhe të vitit 2010 dhe nga kredia e marrë. Çmimi i apartamentit është 4.000.000 lekë.”*

- Në deklaratën “Vetting” pasuria është deklaruar me të njëjtat deklarime.

Nuk janë konstatuar mospërputhje dhe pasaktësi në deklarime.

3.2 Në lidhje me origjinën, mënyrën e krijimit të pasurisë dhe likuidimin e çmimit të shitjes, nga aktet¹⁴ në dosje rezultoi se në rend kronologjik janë kryer veprimet, si vijojnë:

- Me kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 23.11.2006, pala porositëse A. B. ka porositur te shoqëria “****” sh.p.k., ndërtimin e një banese 7-katëshe.
- Me kontratën për kalim të drejtash nr. ***, datë 11.12.2010, të lidhur mes palëve A. B. (palë e parë), Genti Xholi (palë e dytë) dhe shoqërisë “****” sh.p.k. (pala e tretë), shtetasit Genti Xholi i kalojnë të gjitha të drejtat e palës së parë, në cilësinë e pronarit të truallit (përfutur nga kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 23.11.2006), në vlerën 4.000.000 lekë, shumë e cila është paguar plotësisht para redaktimit të kontratës.
- Me certifikatën për vërtetim pronësie datë 2.9.2016, të ZVRPP-së Pogradec, pasuria nr. *** rezulton e regjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.
- Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 10.9.2016, deklaruesit A. Xh. dhe A. B. japin pëlqimin që shitja përfundimtare e apartamentit me nr. pasurie ***, të bëhet në emër të blerësit Genti Xholi. Deklaruesi A. B. deklaron se në bazë të kontratës së kalimit të të drejtave nr. ***, datë 11.12.2010, i është likuiduar totalisht shuma prej 4.000.000 lekësh, nga blerësi Genti Xholi.
- Me kontratën e shitblerjes nr. ***, nr. 10.9.2016, pala shitëse, shoqëria “****” sh.p.k., i ka shitur blerësit Genti Xholi pasurinë nr. ***, me çmimin 4.000.000 lekë, paguar shitësit në datën 11.12.2010, kur është lidhur kontrata për kalim të drejtash.

Subjekti, pasi u pyet mbi mënyrën e likuidimit të çmimit të shitjes, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 deklaroi se: *...shuma prej 4.000.000 lekësh i është paguar shitësit A. B. dhe jo shoqërisë ‘****’ sh.p.k., pasi ky shtetas kishte të drejtat mbi këtë apartament në cilësinë e pronarit të truallit. Kjo shumë i është paguar shitësit në dorë dhe jo me veprim bankar. ...pavarësisht se*

¹² Shihni shkresën e dërguar paraprakisht me e-mail në datën 24.10.2019, nga adresa zyrtare e znj. M. H.

¹³ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 31.1.2019, nga OSHEE-ja, në dosjen e Komisionit.

¹⁴ Shihni aktet në aneksin 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

në kontratën tip, parashikohet se shuma është paguar plotësisht në datën 11.12.2010, në të vërtetë ajo është paguar në dy këste, me marrëveshje mirëkuptimi mes palëve. ... shuma prej 3.000.000 lekësh i është dhënë shtetasit A. B. në datën 11.12.2010 (dita e lidhjes së kontratës) kurse pjesa e mbetur prej 1.000.000 lekësh, i është dhënë në datë 27.12.2010, me tërheqjen e kredisë nga banka...

Për të vërtetuar këtë pretendim, subjekti ka vënë në dispozicion deklaratën datë 20.9.2019 të shtetasit A. B., i cili konfirmon pretendimin e subjektit.

Për sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, u konstatua se: (i) çmimi i shitjes së pasurisë nuk është likuiduar në mënyrën e parashikuar në kontratën e shitjes së datës 10.9.2016, sipas të cilës shuma prej 4.000.000 lekësh është paguar plotësisht para redaktimit të kontratës, konkretisht, me kalimin e të drejtave të pronësisë në datën 11.12.2010; (ii) në deklaratën “Vetting” mungojnë të jenë dhënë detaje lidhur me likuidimin e çmimit të shitjes, sipas deklaramëve gjatë procesit të rivlerësimit.

Në lidhje me këto konstatime, subjektit iu kërkuan sqarime, me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e datës 24.11.2019, por dhe në seancë dëgjimore, pranoi mospërputhjen midis parashikimeve kontraktore dhe mënyrës reale të likuidimit të shumës 4.000.000 lekë, duke risqaruar se, kjo shumë, pavarësisht pasqyrimin në kontratën “tip” të datës 10.9.2016, i është paguar shtetasit A. B. me dy këste, përkatësisht: (1) shuma prej 3.000.000 lekësh është paguar në datën 11.12.2010, me burim kursimet familjare; dhe (2) shuma prej 1.000.000 lekësh është paguar 16 ditë më vonë, në datën 27.12.2010, me tërheqjen e kredisë nga “Raiffeisen Bank”.

Në lidhje me konstatimin se në deklaratën “Vetting” nuk është sqaruar mënyra e likuidimit të çmimit si më sipër, subjekti ka sqaruar se: ... referuar rubrikës “deklarimi i pasurive”, të deklaratës “Vetting”, kërkohet tekstualisht “Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë”, dhe për këtë arsye nuk ka dhënë sqarime mbi mënyrën e likuidimit..”.

Vlerësimi nga Komisioni

Në përfundim të procesit, Komisioni i konsideroi bindëse argumentet e subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit, kontrata e nënshkruar prej palëve ka qenë një kontratë “tip”, dhe se nga shuma e çmimit të blerjes së pasurisë prej 4.000.000 lekësh, vetëm pjesa prej 3.000.000 lekësh është paguar në datën 11.12.2010, ndërsa shuma prej 1.000.000 lekësh është paguar 16 ditë më vonë, në datën 27.12.2010, kur është marrë një kredi nga “Raiffeisen Bank”, referuar provave shkresore, si vijojnë:

i) Konfirmim zyrtar nga “Raiffeisen Bank”¹⁵ për marrjen e një kredie në shumën 1.000.000 lekë pranë kësaj banke nga subjektit, e cila është disbursuar në datën 23.12.2010, dhe është tërhequr nga subjekti në *cash*, në datën 27.12.2010.

ii) Në deklaratat periodike për vitet 2010 dhe 2012, subjekti ka deklaruar kredinë prej 1.000.000 lekësh, si një nga burimet e pasurisë objekt shqyrtimi (së bashku me kursimet familjare), duke vijuar me të njëjtat deklaramëve edhe në deklaratën “Vetting”.

¹⁵ Shkresa nr. ***prot., datë 25.1.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni ka kryer analizën financiare, duke konsideruar si burime krijimi të pasurisë objekt shqyrtimi: (1) kursimet familjare për shumën 3.000.000 lekë, deri në datën 11.12.2010, data e lidhjes së kontratës paraprake; dhe (2) kredinë prej 1.000.000 lekësh, disbursuar në datën 23.12.2010, tërhequr nga subjekti në *cash*, në datën 27.12.2010.

Nga kjo analizë, e pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, rezulton se subjekti ka pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie.

	Përshkrimi	2010
1	PASURI	2.508.585
	Autoveturë "Benz S300" targa ****	150.000
	Kalim të drejtash apartamenti 103.46 m ² , Pogradec	4.000.000
	Pakësime likuiditete	-1.641.415
2	DETYRIME	1.000.000
	Kredi "Raiffeisen Bank"	1.000.000
3	PASURI NETO (1-2)	1.508.585
4	TË ARDHURA	2.495.842
	Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit	1.620.133
	Të ardhura nga paga bashkëshortja	873.625
	Të ardhura nga interesa bankare	2.084
5	SHPENZIME	960.549
	Mobilim apartamenti në Pogradec, sipas pyetësorit standard	300.000
	Shpenzime me kartë krediti	45.642
	Shpenzime jetese ILDKPKI	478.170
	Shpenzime udhëtimi	51.737
	Shpenzime arredimi	85.000
	DIFERENCA (TË ARDHURA-PASURI-SHPENZIME 4-3-5)	26.708

3.3 Në lidhje me një trajtim të mundshëm preferencial për blerjen e kësaj pasurie:

Referuar udhëzimit nr. 3, datë 3.2.2010, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, çmimi mesatar i shitjes për lekë/ m² në vitin 2010 në qytetin e Pogradecit ka qenë 46.057 lekë/m², ndërsa çmimi i blerjes së apartamentit nga subjekti është 38.662 lekë/m², pra, 7.395 lekë/m² më lirë. Sipas këtij çmimi, apartamenti me sip. 103.46 m² do të kushtonte 4.765.057 lekë. Në total, subjekti e ka blerë pasurinë me një vlerë 765.000 lekë më pak se vlera e llogaritur sipas çmimit të referencës nga EKB-ja.

Për të parë nëse subjekti është favorizuar nga shitësi për blerjen e pasurisë, janë kryer veprime verifikuese, si vijojnë:

3.3.a Subjekti u pyet mbi marrëdhënien e tij me shtetasit A. Xh. dhe A. B., si dhe nëse ka pasur për shqyrtim çështje të tyre dhe të shoqërisë "****" sh.p.k., i cili në përgjigjet e pyetësorit të dytë, deklaroi se nuk ka pasur asnjë marrëdhënie familjare apo shoqërore me këta shtetas. Në lidhje me shtetasin A. B., subjekti sqaron se banon në të njëjtin kat të ndërtesës dhe konsiderohet prej tij thjesht një fqinj. Subjekti deklaroi, gjithashtu, se gjatë ushtrimit të

funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në Prokurorinë e Apelit Tiranë, nuk e ka përfaqësuar organin e akuzës në asnjë procedim me palë këta subjekte.

Deklarimet e subjektit vërtetohen me vërtetimet e lëshuara nga Prokuroria e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit Tiranë, sipas të cilave: (i) nuk rezultoi të jetë regjistruar ndonjë procedim penal për shtetasit A. Xh., A. B., ndërsa shtetasi Genti Xholi nuk ka përfaqësuar akuzën në çështje gjyqësore, ku palë kanë qenë këta shtetas; (ii) ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., nuk është regjistruar ndonjë procedim penal.

3.3.b Nga verifikimi i 39 kontratave të vëna në dispozicion nga ASHK-ja Pogradec¹⁶, referuar çmimit për m² për secilën prej tyre, për pasuri të ndodhura në të njëjtën godinë, nuk mund të arrihet në konkluzionin që subjekti është trajtuar me një çmim preferencial. Ndërkohë, në 10 prej tyre, çmimi për lekë/m² rezulton të jetë edhe më i lirë nga çmimi i ofruar për subjektin e rivlerësimit.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, bazuar në sa më sipër, si dhe referuar faktit që gjatë hetimit administrativ nuk ka pasur asnjë të dhënë nga cilido burim, për përfitim të paligjshëm të pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, nuk rezultoi që subjekti të jetë trajtuar në mënyrë preferenciale për blerjen e pasurisë apartament banimi në Pogradec, për shkak të ushtrimit të funksioneve të tij si prokuror.

4. Që në qershor të vitit 2016 nga shtetasi I. P., babai i bashkëshortes, është vënë në përdorim të përkohshëm të subjektit, për të banuar së bashku me familjen, një apartament të ndodhur në Rr. “****”, kompleksi “****”, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë.

Duke qenë se subjekti është në një marrëdhënie huapërdorje me shtetasin I. P., ky shtetas konsiderohet person tjetër i lidhur, sipas nenit 3/14 dhe nenit 32/4, të ligjit nr. 84/2016. Si rrjedhim, gjatë hetimit administrativ janë kryer disa veprime hetimore në lidhje me këtë pasuri dhe mundësinë financiare të këtij shtetasi, në cilësinë e personit të lidhur, për të krijuar këtë pasuri.

Pas verifikimeve, në lidhje me këtë pasuri, rezultoi se:

- ZVRPP-ja Tiranë¹⁷ informoi se në emër të shtetasit I. Ll. P. është e regjistruar pasuria apartament me sip. 93.7 m², me nr. pasurie ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***, me adresë: Rr. “****”, shk. ***, k. ***, ap. ***.

- OSHEE-ja¹⁸ konfirmoi në emër të I. P. kodin e kontratës ***, me vendndodhje në Rr. “****”, me datë hapjeje 14.9.2011.

4.1. Në lidhje me mënyrën e krijimit të kësaj pasurie, nga aktet në dosje¹⁹ rezulton se në rend kronologjik janë kryer veprimet si vijojnë:

4.1.a Me kontratë noteriale porosie nr. ***, datë 31.5.2010, shtetasi I. P. ka porositur nga shoqëria ndërtimore “****” sh.p.k., një apartament me sip. 107.7 m², me sip. të brendshme 93.7 m² dhe me sip. të përbashkët 14 m², në bashkëpronësi, në vlerën 5.900.000 lekë.

4.1.b Me vërtetimin e pronësisë datë 13.4.2012, vërtetohet se në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 5.4.2012, në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., figuron e regjistruar pasuria nr. ***, apartament me sip. 93.7 m².

¹⁶ Shihni shkresën e dërguar paraprakisht me *e-mail* në datën 24.10.2019, nga adresa zyrtare e znj. M. H.

¹⁷ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot., datë 8.2.2019, nga ZVRPP-ja Tiranë, në dosjen e Komisionit.

¹⁸ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot., datë 31.1.2019, dhe shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot., datë 7.2.2019, nga OSHEE-ja, në dosjen e Komisionit.

¹⁹ Shihni aktet në aneksin 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit, dërguar nga subjekti në rrugë elektronike në datën 30.9.2019, në dosjen e Komisionit.

4.1.c Me kontratën noteriale të nr. ***, datë 27.5.2013, blerësi I. P. e ka blerë këtë apartament nga shoqëria ndërtimore “****” sh.p.k., në çmimin 7.530.000 lekë, ose 53.850 euro.

Duke qenë se kontrata e porosisë dhe ajo e shitjes kanë mospërputhje në çmimin e shitjes, iu kërkua informacion noteres E. T., e cila ka bërë redaktimin dhe legalizimin e akteve përkatëse noteriale, e cila konfirmoi faktin se kontrata e porosisë dhe ajo e shitjes bëjnë fjalë për të njëjtën pasuri²⁰.

4.1.d Me vërtetimin e pronësisë datë 31.03.2014, vërtetohet se në emër të shtetasit I.Ll. P., figuron e regjistruar pasuria nr. ***.

4.2. Në lidhje me mënyrën e likuidimit të çmimit të blerjes së pasurisë nga personi i lidhur Ilrakli Pano, u konstata se:

4.2.a Në kontratën e shitjes nr. ***, datë 27.5.2013, përcaktohet se çmimi prej 7.530.000 lekësh (shuma ekuivalente në euro 53.850) është likuiduar tërësisht nga blerësi I. P..

Subjekti, pasi u pyet në lidhje me mënyrën e likuidimit të kësaj shume, në përgjigje të pyetësorit të dytë, ka sqaruar: ... *likuidimi i kësaj shume është bërë nga I. P., në tre këste*, duke vënë në dispozicion tri akte bankare të “Raiffeisen Bank”, që vërtetojnë pagimin e shumës në total 53.850 euro, si vijon :

- akt bankar, datë 31.5.2010, veprim arke me përshkrim “derdhje kësti i parë për prentim apartamenti”, nga I. P., në shumën 10.000 euro, për shoqërinë “****” sh.p.k.;
- akt bankar datë 18.1.2011, veprim arke me përshkrim “derdhje kësti i dytë për prentim apartamenti” nga I. P., në shumën 20.000 euro, për shoqërinë “****” sh.p.k.;
- akt bankar datë 17.10.2011, depozitim për të tretë, me përshkrim “pagesë kësti i fundit”, nga I. P. për shoqërinë “****” sh.p.k., në shumën 23.850 euro.

4.2.b Duke qenë se në përfundim të hetimit administrativ nuk u vërtetua që personi i lidhur, z. I. P., t’i ketë pasur të depozituara në bankë këto shuma dhe, si rrjedhim, ka qenë e paqartë origjina e çmimit të blerjes së pasurisë prej 53.850 euro, me kalimin e barrës së provës, subjektit i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

Subjekti, në parashtrimet e datës 24.11.2019, ashtu edhe në seancën dëgjimore, ka sqaruar se kjo shumë, që buron nga aktiviteti tregtar i shtetasit I. P., si dhe kursimet e familjes së tij, e cila krahas bashkëshortes D. P., përbëhet edhe nga dy fëmijët e tyre S. dhe Ll. P., nuk ka qenë e depozituar në bankë, por, është mbajtur në shtëpi e depozituar *cash* prej tij.

4.3 Lidhur me mundësinë financiare të shtetasit I. P. për blerjen e pasurisë:

Me qëllim një vlerësim sa më objektiv të burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë nr. ***, nga Komisioni u kryen veprimet hetimore, si vijojnë:

4.3.a Subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar të dhëna në lidhje me të ardhurat ligjore të personit të lidhur I. P., i cili ka sqaruar se ky shtetas është person fizik, i regjistruar në zyrën tatimore, dega Tiranë, që nga viti 1994 e në vijim, duke vënë në dispozicion dokumente shkresore²¹ për të vërtetuar të ardhurat e tij, nga verifikimi i të cilave, rezultoi se:

- për periudhën 1995 – 2006, Drejtoria Tatimore Tiranë nuk ka informacion për fitimin e realizuar, por vetëm për qarkullimin në shumën 6.433.333 lekë. Në këto kushte, në pamundësi për të vërtetuar normën e fitimit mbi qarkullimin, nisur nga lloji i biznesit (i vogël), në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka vlerësuar që norma e fitimit të personit të

²⁰ Shihni shkresën nr. ***prot., datë 8.11.2019, të noteres E. T., në dosjen e Komisionit.

²¹ Shkresa nr. *** prot., datë 27.9.2019, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, si dhe *statement* të llogarive nga “Raiffeisen Bank” dhe “OTP Bank”.

lidhur, z. I. P., të llogaritet 15 % e qarkullimit. Sipas kësaj përlllogaritjeje, fitimi neto i llogaritur për periudhën 1995 – 2006, është 965.000 lekë;

- për periudhën 2009 – 2011, fitimi neto ka qenë 1.348.155 lekë.

Për sa më sipër, për periudhën 1994 – 2011 (kur është blerë pasuria), të ardhurat e ligjshme të personit të lidhur I. P., janë llogaritur në shumën 2.313.155 lekë, pasqyruar si në tabelën e mëposhtme:

VITI	Qarkullim i deklaruar	Fitim neto	TOTAL
1995	500.000		
1999	700.000		
2000	2.000.000		
2003	300.000		
2004	600.000		
2005	1.000.000		
2006	1.333.333		
2007			
2009		338.920	
2010		684.735	
2011		324.500	
TOTAL	6.433.333	1.348.155	
Fitim 15 % i qarkullimit	965.000	1.348.155	2.313.155

4.3.b Iu kërkuan të dhëna Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, lidhur me të ardhura të tjera të shtetasit I. P., dhe ky institucion vërtetoi se, z. I. P. ka qenë aksioner në shoqërinë “****” sh.a., me 0.08 % të aksioneve²². Kjo shoqëri ka pasur fitime nga viti 1994 - 2017, por nuk ka shpërndarë dividend. Si rrjedhim, të ardhurat e tij si aksioner në këtë shoqëri, përveç se janë në vlera të ulëta, nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme, për shkak se nuk është shpërndarë dividend.

4.3.c Subjekti i rivlerësimit u ripyet lidhur me të ardhura të tjera të personit të lidhur I. P., i cili në përgjigjet e pyetësorit të tretë, ka deklaruar se: ... *familja e I. P.s, krahas bashkëshortes së tij, znj. D. P., është e përbërë edhe nga dy fëmijët e tij S. P. e Ll. P. (jeton e punon prej dy vitesh në Katar), të cilët pas martesës kanë krijuar ekonomi më vete (znj. S. P. në vitin 2012 është martuar dhe larguar nga banesa)....*

Lidhur me të ardhurat e këtyre shtetasve, subjekti ka vënë në dispozicion:

- vërtetimin²³ e të ardhurave nga pagat e kunatit të tij, shtetasit Ll. P., lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., sipas të cilit të ardhurat e tij deri në vitin 2011, kur është blerë pasuria, kanë qenë në shumën 372.783 lekë.

²² Shihni shkresën nr. ***prot., datë 23.10.2019, të DPTT-së, në dosjen e Komisionit.

²³ Shihni vërtetimin nr. *** prot., datë 11.10.2019, nga shoqëria “****” sh.p.k., dërguar nga subjekti në rrugë elektronike në datën 14.10.2019, në dosjen e Komisionit.

- vërtetimin²⁴ e të ardhurave nga pagat e kumatës së tij, shtetas S. P., lëshuar nga Telekom Albania për periudhën 2008 – 2019, sipas të cilit, të ardhurat deri në vitin 2011, kur është blerë pasuria, kanë qenë në shumën 5.975.837 lekë.

Duke qenë se të ardhurat e sipërpërmendura të shtetasve Ll.dhe S. P., nuk vërtetohet të jenë përdorur për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi, subjektit iu kërkuan sqarime, i cili në parashtrimet e datës 24.11.2019 dhe në seancën dëgjimore deklaroi se këta shtetas të ardhurat nga puna ia kanë vënë në dispozicion babait të tyre, z. I. P., i cili i ka përdorur për të blerë apartamentin objekt shqyrtimi. Për të vërtetuar këto pretendime subjekti ka vënë në dispozicion:

- deklaratë personale (pa datë) të shtetasit I. P.;
- deklaratë personale datë 17.11.2019, të shtetasit Ll. P.;
- deklaratë personale datë 18.11.2019, të shtetas S. P.,

akte sipas të cilave, të ardhurat e përfituara nga secili prej tyre janë menaxhuar nga kryefamiljari I. P., duke u konsideruar të ardhura të përbashkëta familjare dhe janë përdorur prej tij për blerjen e një apartamenti të ndodhur në adresën Rr. “****”, kompleksi “****”, shk. ****, k. ****, ap. ****, Tiranë.

Përveç hetimeve si më sipër, lidhur me burimin e ligjshëm të shtetasit I. P. për blerjen e pasurisë, Komisioni kreu disa hetime për të hequr çdo dyshim për pronësinë e mundshme të subjektit të rivlerësimit, apo bashkëshortes së tij, mbi pasurinë apartament banimi në pronësi të personit të lidhur I. P.. Konkretisht:

a. Iu kërkua informacion Shoqërisë “****” sh.p.k., në lidhje me porositësin fillestar të pasurisë dhe marrëveshjet që i përkasin apartamentit objekt shqyrtimi. Kjo shoqëri konfirmoi se²⁵, apartamenti me sip. 93.7 m², me nr. pasurie ****, është porositur me kontratë porosie nr. ****, datë 31.5.2010, nga z. I. P., me të cilin është lidhur edhe kontrata e shitjes, nr. ****, datë 27.5.2013.

b. U kërkua informacion në lidhje me konfliktin e mundshëm të interesit të subjektit me shoqërinë ndërtimore dhe administratorin e saj. Sipas vërtetimeve të lëshuara nga Prokuroria e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë²⁶, nuk vërtetohet që subjekti të ketë shqyrtuar çështje me palë shoqërinë “****” sh.p.k., dhe shtetasen A. D., administratore e shoqërisë.

c. U kërkua informacion nga OSHEE-ja në lidhje me shpenzimet e energjisë elektrike dhe faturimet përkatëse, me qëllim verifikimin e periudhës se kur është vënë kjo pasuri në përdorim si dhe verifikimin e abonentit përdorues. Ky institucion informoi se²⁷, për këtë apartament është lidhur kontrata e energjisë elektrike në datën 14.9.2011, në emër të shtetasit I. P., ndërsa shpenzimet e energjisë kanë filluar që prej vitit 2012 në vlera të vogla (afrofe), të cilat pësojnë rritje vetëm në nëntor të vitit 2015, fakt që tregon fillimin e përdorimit të pasurisë në këtë

²⁴ Shihni vërtetimin datë 14.10.2019, lëshuar nga Telekom Albania sh.a., dërguar nga subjekti në rrugë elektronike, në datën 16.10.2019, në dosjen e Komisionit.

²⁵ Shihni shkresën kthim-përgjigje nga shoqëria “****” sh.p.k., protokolluar nga Komisioni me nr. **** prot., datë 28.10.2019, në dosjen e Komisionit.

²⁶ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. ****prot, datë 26.9.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, dhe shkresën kthim-përgjigje nr. ****prot., datë 23.9.2019, nga Gjykata e Apelit Tiranë, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

²⁷ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. ****prot., datë 31.1.2019, dhe shkresën kthim-përgjigje nr. ****prot., datë 7.2.2019, nga OSHEE-ja, në dosjen e Komisionit.

periudhë (shtatë muaj përpara qershorit të vitit 2016, kur subjekti ka deklaruar banimin në këtë pasuri).

Subjekti, pasi është pyetur se nga kush është përdorur kjo banesë deri sa ai ka filluar ta përdorë, në përgjigjet e pyetësorit të datës 16.10.2019, deklaroi se kjo banesë ka qenë në posedim vetëm nga vjehri i tij I. P.. Për të vërtetuar pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur dokumentet shkresore, si vijojnë:

- Deklaratë datë 23.10.2019, të z. S. Z., administrator i zgjedhur i kompleksit “****” sh.p.k., i cili konfirmon deklarinimet e subjektit.

- Librezën e furnizimit me energji dhe ujë të këtij apartamenti²⁸, të cilat rezultuan të dyja në emër të shtetasit I. P..

d. U kërkuan informacione për lidhje interneti në favor të subjektit dhe familjarëve të tij prej Operatorëve Albtelecom, Abcom, Tring dhe Abcom, të cilët ofrojnë shërbim interneti. Nga të dhënat e vëna në dispozicion, nuk rezultuan kontrata shërbimi interneti apo telefonie fikse në emër të subjektit²⁹ për këtë pasuri, dhe jo vetëm.

e. Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga bankat e çdo niveli, nuk u vërtetuan transaksione bankare të kryera nga subjekti apo bashkëshortja e tij, në lidhje me këtë pasuri.

Përveç hetimeve si më sipër, me qëllim identifikimin e pasurive të tjera të personit të lidhur, z. I. P., u kryen veprimet hetimore si vijojnë:

a. Iu kërkua informacion ZVRPP-së dhe DSHTRR-së Tiranë, në lidhje me pasuri të tjera të personit të lidhur I. P., dhe me informacionin e vënë në dispozicion³⁰ u konstatua se personi i lidhur, I. P., përveç pasurisë nr. ***, të dhënë në huapërdorje subjektit të rivlerësimit, ka përfituar pronësinë edhe mbi pasuritë si vijojnë:

- pasuria nr. ***, garazh me sip. 27 m², blerë në datën 29.12.2004³¹, me çmim 1.200.000 lekë, me adresë: Rr. “****”, hyrja ***;

- pasuria nr. ***, njësi, me sip. 27 m²³², me vlerë 500.000 lekë, me adresë: Rr. “****”, hyrja 6, për të cilën, subjekti ka deklaruar³³ se njësia me vlerë 500.000 lekë është blerë dhe regjistruar nga vjehri i tij në vitin 2002, duke e vërtetuar këtë fakt me: (1) kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 11.11.2002; dhe (2) vërtetim pronësie datë 12.11.2002;

- pasuria nr. ***, apartament, me sip. 73.65 m²³⁴, përfituar nga privatizimi, sipas kontratës datë 15.12.1993³⁵ (me vlerë të pakonsiderueshme), me adresë: Rr. “****”, godina ***, hyrja ***, ap. ***, në të cilën është ndërtuar shtesë kati me sip. 35.7 m², e cila ka kaluar në proces legalizimi³⁶, në vlerën 1.067.787 lekë;

- automjet tip “Volkswagen Golf”, blerë në datën 23.2.2004³⁷, me çmim blerjeje 50.000 lekë;

²⁸ Shihni librezat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit datë 16.10.2019, në dosjen e Komisionit.

²⁹ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 21.10.2019 nga shoqëria “Abissnet” sh.a.; shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 23.10.2019, nga “Albtelecom” sh.a.; dhe shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 28.10.2019, nga “Tring” sh.p.k., në dosjen e Komisionit.

³⁰ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 8.2.2019, nga ZVRPP-ja Tiranë dhe shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 24.1.2019, nga DPSHTRR-ja, në dosjen e Komisionit.

³¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 8.2.2019, të ZVRPP-së Tiranë, në dosjen e Komisionit.

³² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 8.2.2019, të ZVRPP-së Tiranë, në dosjen e Komisionit.

³³ Shihni sqarimet e subjektit pas rezultateve të hetimit, dërguar në rugë elektronike në datën 24.11.2019, në dosjen e Komisionit.

³⁴ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 8.2.2019, të ZVRPP-së Tiranë, në dosjen e Komisionit.

³⁵ Shihni dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, në dosjen e Komisionit.

³⁶ Shihni dokumentet bashkëngjitur shkresës nr. *** prot., datë 13.3.2019, të ALUIZNI-t Tiranë, në dosjen e Komisionit.

³⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 6.2.2019, të DPSHTRR-së, në dosjen e Komisionit.

- automjet tip “Fiat Tempra”, blerë në datën 20.4.2007³⁸, me çmim blerjeje 250.000 lekë.

(Në total, të gjitha pasuritë kapin vlerën 10.612.822 lekë.)

b. Iu kërkuan të dhëna kompanive të internetit, në lidhje me kontrata të lidhura në emër të z. I. P.. Sipas informacionit të Albtelecom sh.a.,³⁹ shtetasi I. Ll. P. ka kryer lidhje interneti dhe telefoni fikse me këtë kompani, për një pasuri me adresën: Rr. “***”, shk. ***, kodit postar ***, Tiranë, në datën 4.10.2016, ndërkohë që, gjatë hetimit administrativ nuk ka rezultuar ndonjë pasuri e këtij shtetasi në këtë adresë.

Subjekti, pasi i është kërkuar të japë sqarime lidhur me këtë konstatim, në parashtrimet datë 24.11.2019, ka sqaruar se në vitin 2005, nga bashkia është bërë ndryshimi i adresës, pasi, Rr. “****”, ku ndodhet apartamenti i vjehrrit (pasuria nr. ***) ka marrë emrin Rr. “****”, duke e vërtetuar këtë pretendim me vërtetimin e njësisë administrative nr. ***, Bashkia Tiranë, lëshuar në datën 14.11.2019.

Nisur nga ky informacion si dhe nga të dhënat e ZVRPP-së Tiranë, z. I. P. nuk u vërtetua të ketë në pronësi pasuri të tjera, të ndryshme nga ato të verifikuara gjatë hetimit administrativ.

Në analizë të të gjitha provave të administruara si më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni konstatoi se, përveç faktit që subjekti banon që nga qershori i vitit 2016 në apartamentin e banimit në pronësi të vjehrrit të tij, z. I. P., nuk u evidentuan lidhje të tij apo të bashkëshortes, me këtë pasuri.

Por, pavarësisht këtij konstatimi, referuar rrethanave, sipas të cilave: (i) duket që personi i lidhur, z. I. P., nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e pasurisë nr. ***; (ii) kjo banesë nuk është përdorur as nga shtetasi I. P., dhe as nga ndonjë person tjetër, deri në nëntor të vitit 2015; (iii) personi i lidhur, z. I. P., ka në pronësi një banesë tjetër me vendndodhje Rr. “****”, të cilën e ka përdorur që nga viti 2007 e në vijim; (iv) nuk u vërtetua likuidimi i çmimit të blerjes së pasurisë nga blerësi I. P. në rrugë bankare, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i janë kërkuar të japë sqarime në lidhje me faktet: (1) përse ky apartament është blerë nga z. I. P., ndërkohë që nuk është përdorur prej tij dhe as nga persona të tjerë; (2) me çfarë të ardhurash është blerë kjo pasuri, ndërkohë që shtetasi I. P., duket se nuk ka pasur mundësi financiare për blerjen e saj.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti, në parashtrimet e tij datë 24.11.2019, por edhe në seancën dëgjimore, ka vijuar të pretendojë se pasuria në fjalë është e vjehrrit të tij I. P., blerë me të ardhura plotësisht të mjaftueshme të përbashkëta të familjes së tij, pasuri e cila, me vullnet të lirë dhe dëshirë të plotë i është lejuar vajzës së tij, bashkëshortes së subjektit, znj. N. Xh., të banojë familjarisht në qershor të vitit 2016, dhe në vijim, në pritje të një ndërtimi mbi truallin e banesës së vjetër, ku subjekti do të përfitonte sipërfaqe banimi në cilësinë e bashkëpronarit, duke i argumentuar dhe vërtetuar këto pretendime, si vijon:

1. Në lidhje me të ardhurat e ligjshme të gjeneruara nga biznesi i shtetasit I. P., subjekti ka pretenduar se: *Ky shtetas është i regjistruar në sistemin tatimor, si person fizik, me aktivitet riparim pajisje elektro-shtepiake, biznes i vogël, me të ardhura nën 2.000.000 lekë. Bizneset e kësaj kategorie nuk e kanë pasur të detyrueshme deklarimin e pasqyrave financiare deri në vitin 2006, por ka qenë e detyrueshme të deklarohet xhiro e subjekteve tregtare (të ardhurat nga shitjet). Ndërsa, për vitet 2007 dhe në vijim, është bërë vetëm deklaratë përmbledhëse e të ardhurave/shpenzimeve. ...Nisur nga aktiviteti i tij, si dhe fakti që nuk ka pasur shpenzime*

³⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 6.2.2019, të DPSHTRR-së, në dosjen e Komisionit.

³⁹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 23.10.2019, në dosjen e Komisionit dhe kontratën bashkëngjitur.

qiraje për ushtrimin e tij, norma e fitimit mbi qarkullimin është më e lartë sesa marzha e fitimit, e përlllogaritur nga Komisioni (1 5% mbi qarkullimin).

Pretendimet e subjektit janë materializuar në raportin, datë 15.11.2019 të ekspertit kontabël Q. K., sipas të cilit, fitimi neto për periudhën 1995 – 2006 ka qenë në vlerën 4.440.940 lekë, duke llogaritur normën e fitimit 69 % të qarkullimit. Ndërsa, për periudhën 2007 – 2011 fitimi neto ka qenë në vlerën 1.272.155 lekë. Referuar këtij raporti, totali i fitimit neto të gjeneruar nga subjekti tregtar I. P., për periudhën 1995 – 2011, ka qenë në vlerën 5.713.095 lekë, ndërkohë që fitimi i llogaritur nga Komisioni ka qenë 2.313.155 lekë.

2. Në lidhje me të ardhurat e tjera të ligjshme të shtetasit I. P. për blerjen e pasurisë, subjekti vijon të këmbëngulë në faktin se kanë kontribuar me të ardhurat e tyre edhe shtetasit Ll. (372.783 lekë) dhe S. P. (5.975.837 lekë), të cilët kanë qenë pjesë përbërëse e gjendjes familjare të z. I. P..

Në lidhje me znj. S. P., subjekti pretendoi se përveç të ardhurave të sipërpërmendura, të siguruara nga kompania Telekom, ajo ka pasur të ardhura edhe nga kompania Vodafone, për periudhën janar 2004 – mars 2008, në shumën 3.143.002 lekë, duke e vërtetuar këtë fakt me vërtetimin datë 17.10.2019, nga Vodafone Albania⁴⁰. Pra, në total, subjekti ka vërtetuar të ardhura të kësaj shtetaseje në shumën 9.118.839 lekë.

3. Në lidhje me paqartësitë për shkak të disa rrethanave, të cilat mund të ngrenë dyshime lidhur me pronësinë e mundshme mbi këtë pasuri, subjekti ka vijuar të deklarojë se kjo pasuri është në pronësi të z. I. P. dhe se blerja e këtij apartamenti është bërë prej tij për shkak të çmimit të arsyeshëm, si një investim me shumë interes i të ardhurave të familjes, vlera e të cilit do të rritej në të ardhmen. Sipas subjektit, fakti që kjo pasuri është vënë si kolateral nga shtetasi I. P., në favor të djalit të tij Ll. P., për një kredi të marrë nga ky i fundit, vërtetuar me kontratën e hipotekës nr. 3857/1918, datë 2.11.2017, është një tregues që subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë lidhje me pronësinë mbi këtë pasuri.

Më tej, ashtu si edhe gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti vijon të argumentojë arsyet e largimit nga banesa e vjetër për në apartamentin në pronësi të vjehrrit të tij, në marrëveshje të plotë me dy bashkëpronarët e tjerë, për shkak të: (i) ardhjes së një situatë të papritur, e kushtëzuar nga sëmundja e pashërueshme e dajës së tij, të ndjerit Xh. Sh. (ii) amortizimit të kësaj banese (trajtuar si me sipër).

Për të vërtetuar pretendimet e tij, subjekti ka referuar si prova:

- Deklaratë personale datë 22.11.2019, të shtetases P. A. (Sh.), e cila si një prej bashkëpronarëve të pasurisë, konfirmon se pasuria në fjalë është kërkuar të shfrytëzohet në mënyrë të barabartë nga të tre bashkëpronarët. Sipas saj, që prej vitit 2015, dhe aktualisht, dy dhoma të kësaj shtëpie, janë të zëna prej pajisjeve të aktivitetit të dajës së tij, të ndjerit Xh. Sh.

- Deklaratë datë 18.11.2019⁴¹, e z. S. K., administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., i cili konfirmon se të gjitha pagesat për blerjen e apartamentit të ndodhur në Rr. “****”, në pronësi të shtetasit I. P., janë në emër të këtij shtetasi, i cili ka bërë porosinë për ndërtimin e apartamentit dhe ka ndjekur të gjitha punimet. Më tej, ky shtetas deklaron se shoqëria “****” sh.p.k., nuk ka pasur asnjë lloj marrëdhënieje kontraktore me persona të tjerë të rrethit familjar apo krushqi të shtetasit I. P..

⁴⁰ Shihni vërtetimin nr. *** prot., datë 5.12.2019, të protokolluar nga Komisioni, dokument i paraqitur gjatë seancës dëgjimore, në dosjen e Komisionit.

⁴¹ Sipas verifikimit në faqen zyrtare të QKB-së, konstatohet se z. S. K. është administrator i shoqërisë “****” sh.p.k.

Vlerësimi i Komisionit

Sipas pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, persona të lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e huadhënësit, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”*.

Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për të vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë apartament banimi, në pronësi të personit të lidhur I. P., përdorur prej tij që nga qershori i vitit 2016.

A.Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, në ushtrim të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet dhe dokumentet e sipërpërcituara, bazuar në të cilat, ai pretendoi se personi i lidhur, ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë.

Për të arritur në një përfundim lidhur me të ardhura të ligjshme të personit të lidhur, te cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë, trupi gjykues çmon se Komisioni, si institucion që ka për funksion rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, është në pamundësi objektive për të kryer analizë financiare të mirëfilltë për pasuritë, të ardhurat, shpenzimet e personit të lidhur I. P. në momentin e blerjes së pasurisë, për shkak të mungesës së të dhënave nga njëra anë, por, edhe për faktin se i mungon tagri ligjor. Por, sipas parashikimit ligjor të pikës 4, të nenit 34, të ligjit nr. 84/2016, ky trup gjykues ka kryer hetime të thelluara, me qëllim verifikimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë së dhënë në huapërdorje. (trajtuar me sipër).

B. Në lidhje me dyshimin për pronësinë e mundshme të subjektit të rivlerësimit mbi pasurinë që ka në huapërdorje, në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues arsyeton se parashikimi ligjor në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit personat e lidhur kanë detyrimin të justifikojnë burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e huave, sidomos në rastin e dhënies në huapërdorje të një pasurie të paluajtshme, i shërben heqjes së çdo dyshimi për pasuri të fshehura të subjekteve të rivlerësimit, në emër të personave të lidhur, apo krijimit të pasurive të këtyre personave, me të ardhura të paligjshme të subjekteve të rivlerësimit.

Në analizë të provave të administruara gjatë procesit të rivlerësimit, në kushtet kur nuk mund të arrihet në një konkluzion të sakte e përfundimtar për mundësinë financiare të personit të lidhur, shtetasit I. P. për blerjen e pasurisë dhënë në huapërdorje subjektit të rivlerësimit, pasi është kryer një hetim i thellë administrativ në lidhje me pronësinë e mundshme të subjektit dhe bashkeshortes së tij mbi këtë pasuri, në përfundim të procesit të rivlerësimit, shkurtimisht, u konstatua se :

- Nuk u vërtetua asnjë akt shkresor zyrtar ose jo zyrtar i nënshkruar nga subjekti apo bashkëshortja e tij, si dhe asnjë transaksion bankar ose jo bankar në emër të tyre, që të ketë lidhje me apartamentin në fjalë, si dhe nuk u vërtetuan kontribute të tyre në blerjen e kësaj pasurie.

- Nuk u vërtetua konflikt interesi midis subjektit, palës shitëse dhe administratorin e saj, në momentin e blerjes së pasurisë.

- Nuk u vërtetuan kontrata të lidhura në emër të subjektit dhe bashkëshortes, me OSHEE-në, UKT-në, kompanitë e telefonisë fikse dhe internetit, si dhe pagesa që kanë lidhje me përdorimin e apartamentit nga ana e tyre, përpara përdorimit të tij.

- Pasuria, objekt shqyrtimi, është vënë si kolateral për marrjen e një kredie në emër të vëllait të bashkëshortes së subjektit, z. Ll. P.

- Kontrata e shitjes përfundimtare së pasurisë është lidhur në datën 27.5.2013. Bazuar në të dhënat e OSHEE-së u vërtetua se, pasuria nuk është përdorur në periudhën 2011 – shtator 2015. Nëse subjekti do ta kishte në pronësinë e tij apartamentin, do të kishte filluar ta përdorte që në vitin 2011, kur apartamenti u furnizua me energji elektrike, ose së paku, në vitin 2013, kur pasuria është blerë me kontratë përfundimtare shitjeje.

- Subjekti arriti të bindë Komisionin për arsyet që e bënë të pamundur vijimin e banimit në banesën e përfutur nga trashëgimia në bashkëpronësi të tij me persona të tjerë, të cilat u bënë shkak për përdorimin e apartamentit në pronësi të personit të lidhur I. P..

- Nuk u evidentua asnjë informacion nga cilido burim i ligjshëm në lidhje me pronësinë e mundshme të subjektit, mbi pasurinë në huapërdorje, si dhe nuk u administrua asnjë provë që të hedhë dritë mbi dyshimin që pasuria është pronë e subjektit dhe e bashkëshortes së tij.

- Deklaratat noteriale ose jo, të paraqitura nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit, edhe pse janë redaktuar gjatë këtij procesi, janë marrë në konsideratë si prova shkresore ose si fillim provash shkresore, për të vërtetuar pretendimet e subjektit, për faktin se ato kanë referuar fakte dhe rrethana në lidhje me personin e lidhur I. P. i cili nuk ka qenë dhe nuk është subjekt deklarues dhe, si rrjedhim, nuk ka pasur detyrim ligjor për të deklaruar dhe vërtetuar pasuri dhe interesa private, fakte rreth tyre, si dhe burimet e krijimit të tyre.

Për sa më sipër, mungesa e një konkluzioni përfundimtar në lidhje me të ardhurat e ligjshme të personit të lidhur I. P. të cilat kanë shërbyer për blerjen e pasurisë, vlerësuar në proporcion me të gjitha faktet dhe rrethanat, sipas të cilave, dyshimet në lidhje me pronësinë e mundshme të subjektit mbi pasurinë, nuk rezultuan të vërtetuara, nuk përbën shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit.

Pasuri të deklaruara të personit të lidhur, znj. N. Xh., bashkëshortes së subjektit,

e cila ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka deklaruar se ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj si më poshtë:

1. Blerje automjeti tip “Renault Megane”, me targa ***, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 20.2.2013. Burimi i krijimit: të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Opel”, sipas kontratës nr. ***, datë 23.5.2013, në shumën 100.000 lekë dhe kursime nga të ardhurat e vitit. Vlera: 2.000 euro. Pjesa takuese: 100 %.

Në lidhje me këtë pasuri, DPSHTRR-ja⁴² konfirmoi pronësinë e automjetit me targa ***, të shtetases N. I. Xh., blerë me kontratë shitblerjeje automjeti nr. 2155/1636, datë 20.2.2013, nga shtetasi A. R., në shumën 2.000 euro, e likuiduar tërësisht.

1.1 Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit, rezultoi se kjo pasuri është deklaruar:

- Në deklarin për vitin 2013, si: *“blerje automjeti tip ‘Renault Megane’ me targa ***, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 20.2.2013. Vlera: 2.000 euro. Pjesa takuese: 100%”*.

- Në deklaratën “Vetting” mjeti është deklaruar me të njëjtat deklarime.

1.2 Në lidhje me burimin e krijimit

Si burim për krijimin e kësaj pasurie janë deklaruar:

⁴² Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot., datë 24.1.2019 dhe shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot., datë 6.2.2019, nga DPSHTRR-ja, në dosjen e Komisionit.

1.2.a Shitja e automjetit tip “Opel” me targa ***, sipas kontratës nr. ***, datë 23.5.2013⁴³, në shumën 100.000 lekë, e deklaruar si pakësim pasurie nga subjekti në deklarin për vitin 2013.

Lidhur me këtë burim, nga verifikimet, rezultoi se shitja e automjetit tip “Opel” (datë 23.5.2013), është bërë tre muaj pas blerjes së automjetit tip “Renault” (datë 20.2.2013).

Duke qenë se ka pasur paqartësi në lidhje me faktin, se si shuma e përfituar nga shitja e automjetit tip “Opel” është përdorur si burim për blerjen e automjetit objekt shqyrtimi, rreth tre muaj më parë se automjeti të shitej, subjekti u pyet në lidhje me këtë konstatim, i cili në përgjigje të pyetësorit të tretë, deklaroi se: *... burimi i saktë i të ardhurave ligjore ka qenë një pjesë nga shitja e automjetit ‘Opel Astra’ dhe pjesa tjetër mbuluar me kredinë e disbursuar në datën 19.2.2013. Vlera prej 100.000 lekësh i është dhënë bashkëshortes së tij nga i vëllai Ll. P. dhe i ati I. P. (blerësi i pasurisë së automjetit ‘Opel’) në momentin e blerjes së automjetit ‘Renault Megane’. .. pavarësisht datës së shitjes në kontratë të automjetit ‘Opel Astra’ ky automjet është marrë në posedim nga blerësit Ll. dhe I. P. që në momentin e dhënies së çmimit të blerjes, pra, në datën 20.2.2013...*

Nga verifikimi i kontratës së shitjes së automjetit tip “Opel”, datë 23.5.2013, vërehet se, palë blerëse janë vëllai dhe babai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Nisur nga marrëdhëniet midis palëve, si dhe nga vlera e vogël e çmimit të shitjes së automjetit tip “Opel”, Komisioni çmoi të konsiderojë të vërtetë pretendimin e subjektit, sipas të cilit, ky çmim prej 100.000 lekësh i është dhënë bashkëshortes së tij në momentin e blerjes së automjetit tip “Renault Megane”, datë 20.2.2013, dhe kontrata e shitjes së automjetit tip “Opel” është formalizuar rreth tre muaj më vonë, në datën 23.5.2013, me marrëveshje midis palëve në kontratë.

Lidhur me autoveturën tip “Opel Astra” u konstatua se, ky automjet është deklaruar nga subjekti në deklarinin periodik për vitin 2006, e blerë në shumën 2.300 euro, përfshirë në analizën financiare të këtij viti, ku ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura për blerjen e automjetit.

Për sa më sipër, shuma prej 100.000 lekësh, e përfituar nga shitja e automjetit tip “Opel”, është konsideruar si burim për blerjen e automjetit tip “Renault Megane” dhe është përfshirë në analizën financiare.

1.2.b Kursime nga të ardhurat e vitit:

Ndërkohë që, si burim të dytë për blerjen e automjetit, subjekti ka deklaruar kursime familjare, gjatë shpjegimeve të dhëna në përgjigje të pyetësorit të tretë, ai ka deklaruar se: *... pjesa tjetër e çmimit të blerjes së mjetit Renault Megane, në pronësi të bashkëshortes, është mbuluar me kredinë e disbursuar në datën 19.2.2013...* Ky deklarin përkon me deklaratën periodike për vitin 2013, ku konstatohet se bashkëshortja e subjektit, znj. N. Xh., ka deklaruar një kredi me afat 19.2.2013 – 19.6.2015, e cila është vërtetuar të jetë marrë dhe të ketë kaluar në llogarinë e saj në “Raiffeisen Bank”⁴⁴ për qëllim personal, në shumën 300.000 lekë, në datën 19.2.2013 dhe është tërhequr në të njëjtën ditë (një ditë më parë se të jetë blerë automjeti tip “Renault”, datë 20.2.2013).

Subjekti, pasi u pyet më konkretisht në lidhje me këtë kredi, po në përgjigjet e pyetësorit të tretë, sqaroi se: *...dy javë pas disbursimit të saj, kredia prej 300.000 lekësh është përthithur në kredinë me limit më të lartë prej 1.000.000 lekësh, disbusurar në datën 1.3.2013, me datë maturimi 1.3.2020..., një pjesë është përdorur për blerje të makinës ‘Renault Megane’, rreth*

⁴³ Shihni kontratën e shitje nr. ***, datë 23.5.2013, bashkëngjitur shkresës nr. ***prot., datë 6.2.2019, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

⁴⁴ Shihni shkresën nr. ***prot., datë 25.1.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

180.000 lekë; shpenzimet e udhëtimit familjar në Itali, rreth 200.000 lekë; shpenzime blerje elektro-shtëpiake 165.000 lekë, një pjesë cash në vlerën 450.000 lekë....

Për sa më sipër, në përfundim të procesit të rivlerësimit u konstatua se si burim për blerjen e automjetit tip “Renault Megane”, në datën 20.2.2013, kanë shërbyer: (i) shuma 100.000 lekë e përfituar nga shitja e automjetit “Opel”; dhe (ii) shuma 180.000 lekë e përfituar me kredi bankare në datën 19.2.2013, e cila u vërtetua të jetë shlyer me kursime të krijuara me të ardhura të ligjshme⁴⁵.

Duke qenë se subjekti nuk e ka specifikuar kredinë si burim në deklaratën “Vetting”, duke përmendur vetëm kursimet familjare (që kanë shërbyer si burim për shlyerjen e saj, si rrjedhim për blerjen e automjetit), kjo përbën një pasaktësi në këtë deklaratë. Por, nisur nga fakti se deklaratimet e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit u përputhën plotësisht me deklaratën periodike për vitin 2013, kur është marrë kredia, si dhe me dokumentet bankare të administruara gjatë hetimit administrativ, si dhe në kushtet kur subjekti ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme gjatë vitit 2013, për të krijuar kursime për shlyerjen e kredisë, kjo pasaktësi nuk është konsideruar si shkak për penalizim të tij.

KONSTATIME TË TJERA

1. Subjekti, në deklarinimin për vitin 2010, ka deklaruar një autoveturë tip “Mercedes Benz”, model S 300, me targa ***, blerë në ankandin e zhvilluar në zbatim të ligjit nr. 10160, datë 15.10.20019, “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, në shumën 150.000 lekë. Ndërkohë, në deklarinimin për vitin 2014, deklarohet shitja e automjetit tip “Mercedes Benz”, me targa ***, sipas kontratës nr. 1698/853, datë 8.9.2014, në shumën 1.700 euro.

Duke qenë se në këto dy deklarime behet fjalë për një automjet të të njëjtit tip, por me targa të ndryshme, subjekti u pyet në lidhje me këto automjete, dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, sqaroi se: ... *bëhet fjalë për të njëjtin mjet me nr. shasie *** dhe se ndryshimi i targave nga *** në *** ka ndodhur për shkak të futjes në qarkullim të targave të reja në Republikën e Shqipërisë...*

Pretendimi i subjektit rezultoi të jetë i bazuar, referuar akteve të vëna në dispozicion prej tij:

- kontratë shitje automjeti nr. ***, datë 28.5.2010, me të cilën Prokuroria e Përgjithshme Tiranë i ka shitur blerësit Genti Xholit autoveturën e markës “Mercedes Benz”, me targa ***, me nr. shasie ***, në shumën 150.000 lekë;
- kontratë shitjeje pasurie të luajtshme nr. ***, datë 8.9.2014, me të cilën shitësi Genti Xholi i ka shitur blerësit B. N., automjetin e markës “Mercedes Benz”, me targa ***, me të njëjtin nr. shasie ***, në shumën 1.700 euro.

2. Në deklarinimin për vitin 2013, është kryer një deklarinim me përshkrimin: “*Kalim të drejtash, kundrejt shpërblimit, sipas kontratës nr. ***, datë 14.12.2013. Përfitues si trashëgimtar i pjesës së trashëgimisë së nënës sime, e drejtë e rrjedhur nga dëshmitë e trashëgimisë nr. 1206, datë 30.3.1993, dhe vendimit nr. ***, datë 3.10.1995, të KKKP-së Durrës. Vlera: 678 euro. Pjesa takuese: 100 %.*”

Me qëllim verifikimin e burimit të kësaj shume, u administruan sqarimet dhe aktet shkresore, të vëna në dispozicion nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2, nga shqyrtimi i të cilave, rezultoi se:

- Me dëshminë e trashëgimisë nr. ***, datë 30.10.1993, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, u përcaktuan trashëgimtarët ligjorë të Xh. Sh., të cilët përfitojnë 1/7 pjesë secili, midis

⁴⁵ Shihni tabelën përmbledhëse të analizës financiare në vendim (viti 2013).

të cilëve edhe F. Xh., e cila, pasi ka ndërruar jetë, ka lënë trashëgimtar ligjor subjektin Genti Xholi.

- Me vendimin nr. ***, datë 3.10.1995, të KKKP-së Durrës, aksionerëve të ish-shoqërisë “****” iu njoh pronësia mbi pronën e ndodhur brenda truallit me sip. 4740 m², e ndodhur në lagjen nr. ***, Rr. “****”, në “****”, mbrapa ambienteve të Muzeut Arkeologjik, Durrës. Sipas listës së aksionerëve bashkëngjitur vendimit, rezulton se z. Xh. Sh. zotëron 285 aksione.

- Me kontratën për kalim të drejtash kundrejt shpërblimit nr. ***, datë 14.12.2013, gjashtë shitësit (trashëgimtarë të Xh. Sh.), midis të cilëve edhe subjekti Genti Xholi, i kanë kaluar kundrejt shpërblimit z. A. V., në cilësinë e blerësit, të gjitha të drejtat që ata kanë në truallin me sip. 4740 m², dhe ndërtesat që ndodhen brenda tij, gjithsej 81.4 aksione, me çmim shitjeje të një aksioni në vlerën 50 euro.

- Nga të ardhurat e përfituara prej shitjes së aksioneve, z. Genti Xholi ka përfituar 1/3 pjesë të z. I. Sh.t, i cili zotëronte 1/7 pjesë të trashëgimlënësit Xh. Sh.. Si rezultat, z. Genti Xholi zotëron 1/21 pjesë të 285 aksioneve, të zotëruara nga Xh. Sh. Duke llogaritur çmimin e shitjes së 1 aksioni prej 50 euro, pjesa takuese e tij është 678 euro.

Në analizë të provave si më sipër, u vërtetua burimi i ligjshëm i shumës 678 euro, deklaruar nga subjekti për vitin 2013.

3. Për të verifikuar kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe për të evidentuar shpenzimet e udhëtimeve, nga verifikimi i hyrje-daljeve në sistemin *TIMS*⁴⁶ rezultoi që, gjatë periudhës së rivlerësimit subjekti ka udhëtuar me automjetet me targa ***, ***, *** (në pronësi të tij dhe bashkëshortes), si dhe automjetet me targa ***, ***, ***, ***.

Subjekti, pasi u pyet në lidhje me pronarët e këtyre automjeteve dhe marrëdhëniet me ta, në përgjigje të pyetësorit të dytë, sqaroi se automjetet e pajisura me këto targa janë automjete që ofrojnë shërbim taksi dhe në një rast, i ofruar nga shoqëria e udhëtimit, deklarime të cilat rezultuan të jenë të sakta, pasi u bë verifikimi i llojit të automjeteve në sistemin *TIMS*.

Siç vërehet, subjekti nuk ka pasur udhëtime private me automjete në pronësi të individëve me precedentë kriminalë, si dhe shpenzimet e udhëtimeve të tij familjarisht, relativisht të ulëta, janë marrë në konsideratë gjatë analizës financiare.

4. Nga të dhënat e siguruar nga “Raiffeisen Bank”⁴⁷, u konstatuan disa kreditime në llogari të bashkëshortes së subjektit nga shtetaset R. C., U. Xh., O. K., E. D., E. Gj., përkatësisht në vlerat 21.012 lekë, 15.500 lekë, 78.060 lekë, 37.330 lekë, 4.500 lekë, në total, në shumën 156.402 lekë.

Subjekti, pasi u pyet në lidhje me këto kreditime, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, sqaroi se shtetaset e sipërcituara kanë qenë kolege të bashkëshortes së tij gjatë periudhës që ka qenë nëpunëse e këtij institucioni, për periudhën janar 2008 – qershor 2016, duke vënë në dispozicion vërtetimin datë 18.9.2019, të lëshuar nga kjo bankë, i cili vërteton pretendimet e tij. Më tej, subjekti sqaroi se, kalimet ndër vite janë bërë për blerje të ndryshme të përbashkëta në internet të kryera me kartat e bashkëshortes së tij, duke vënë në dispozicion deklaratat e nënshkuara nga shtetaset e sipërpërmendura, të cilat konfirmojnë deklaratimet e tij.

⁴⁶ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 29.1.2019, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në dosjen e Komisionit.

⁴⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 25.1.2019, të “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

Në vijim, subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur asnjëherë marrëdhënie me këto shtetase. Ndërkohë, me shkresën nr. *** prot., datë 26.9.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, dhe shkresën nr. *** prot., datë 23.9.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë, vërtetohet se ai, nuk ka pasur në shqyrtim çështje penale që u përkasin personave të sipërpërmendur.

Në analizë të fakteve dhe rrethanave si më sipër, Komisioni i vlerësoi bindëse deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me kreditimet në “Raiffeisen Bank”, në emër të bashkëshortes së tij.

5. Nga të dhënat e siguruar nga “Tirana Bank”⁴⁸ është konstatuar se, bashkëshortja e subjektit, në datën 9.1.2006, ka derdhur në llogarinë e saj bankare shumën 380.000 lekë.

Subjekti, pasi u pyet në lidhje me burimin e kësaj shume, në përgjigje të pytesorit numër dy, ka sqaruar se shuma e derdhur në këtë llogari, ka ardhur nga të ardhurat e gjeneruara prej dasmës së tyre dhe sipas tij: *... shpenzimet totale të dasmës me sa mban mend bashkëshortja, duhet të kenë qenë rreth 600.000 lekë... Dasma është bërë në një ditë të vetme dhe shpenzimet janë ndarë në mënyrë të barabartë midis dy familjeve dhe janë paguar nga prindërit respektivë. ... këto të ardhura janë krijuar në janar të vitit 2006, prandaj dhe janë deklaruar në po këtë vit...*

Gjatë hetimit administrativ, Komisioni iu referua deklaratimit periodik për vitin 2006, ku rezultoi të jenë deklaruar të ardhura nga dasma në shumën 500.000 lekë. Për rrjedhojë, shuma prej 380.000 lekësh, është konsideruar si e ardhur e ligjshme për vitin 2006, duke u përfshirë në analizën financiare në rubrikën të ardhura.

6. Nga të dhënat e regjistrimit noterial⁴⁹, u konstatuan dy kontrata shitje/dhurim për pasuri të luajtshme deri në vlerën 1.000.000 lekë, të cilat nuk kanë qenë të administruara nga ILDKPKI-ja, konkretisht: (1) kontratë nr. ***, datë 23.12.2013 e notere E. H.; dhe (2) kontratë nr. ***, datë 12.12.2014 e notere E. S.

Subjekti, pasi iu kërkuan këto akte, vuri në dispozicion:

- kontratë nr. ***, datë 14.12.2013, të notere E. H., që i përket kontratës për kalim të drejtash kundrejt shpërblimit, të deklaruar në vitin 2013 (trajtuar në pikën 2 më lart).

- kontratë nr. ***, datë 8.9.2014, të notere E. S., që i përket kontratës së shitblerjes së automjetit tip “Mercedes Benz”, me targa ***, deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 (trajtuar në pikën 1 më lart).

Nga të dhënat e vëna në dispozicion prej RNSH-së, nuk ka të dhëna lidhur me pasuri apo të drejta reale të pronësisë, të ndryshme nga ato të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

7. Nga hetimi administrativ u konstatua se subjekti ka deklaruar rregullisht detyrimet financiare në lidhje me gjashtë kredi bankare. Gjithashtu, u vërtetua shlyerja e tyre me të ardhura të ligjshme. Në mënyrë të përmbledhur, marrjet dhe shlyerjet e kredive sipas deklaratave periodike vjetore, janë pasqyruar në tabelën më poshtë:

⁴⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 26.2.2019, të “Tirana Bank”, në dosjen e Komisionit.

⁴⁹ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 1.2.2019, nga Ministria e Drejtësisë, në dosjen e Komisionit.

Pershkrimi kredise	2006	2007	2008	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
Kredi bankare per automjetin Tirana Bank 400.000 leke	400.000										400.000
Shlyerje principal kredi Tirana bank 400.000 leke	-110.154	-200.667	-89.179								-400.000
Marrja dhe shlyerja e kesaj kredie deklaruar ne DPV 2006,2007,2008											
Kredi Raiffeisen bank qellimi personal 1.000.000 leke				1.000.000							1.000.000
Shlyerje principal kredi 1.000.000 leke					-482.343	-517.657					-1.000.000
Marrja dhe shlyerja e kesaj kredie deklaruar ne DPV 2010,2011,2012											
Kredi Raiffeisen Bank 300.000 leke							300.000				300.000
Shlyerje principal kredi 300.000 leke							-300.000				-300.000
Marrja dhe shlyerja e kesaj kredie deklaruar ne DPV 2013											
Kredi Raiffeisen bank qellimi personal 1.000.000 leke							1.000.000				1.000.000
Shlyerje principal kredi 1.000.000 leke							-95.677	-125.903	-778.420		-1.000.000
Marrja dhe shlyerja e kesaj kredie deklaruar ne DPV 2013,2014,2015											
Kredi Raiffeisen 987.426 leke ristrukturim I kredise 1.000.000 leke								987.426			987.426
Shlyerje principal kredi 987.426 leke								-158.370	-829.056		-987.426
Marrja dhe shlyerja e kesaj kredie deklaruar ne DPV 2015,2016											
Kredi Alpha Bank 850.000 leke								0	850.000		850.000
Shlyerje principal kredi 850.000 leke									-69.993		-69.993
Marrja dhe shlyerja e kesaj kredie deklaruar ne DPV 2016											

ANALIZË FINANCIARE

Gjatë hetimit administrativ është kryer një analizë e hollësishme financiare e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, bazuar në gjendjet e likuiditeteve, në të ardhurat e ligjshme, shpenzimet, detyrimet financiare, të deklaruara nga subjekti dhe personat e lidhur, duke i krahasuar me informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore. Nga kjo analizë për periudhën e rivlerësimit 2003 – 2016, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, subjekti nuk rezulton me balanca negative.

	1	2	3	4	5	6
VITI	PASURI	DETYRIME	PASURI NETO (1-2)	TË ARDHURA	SHPENZIME	TË ARDHURA - PASURI-SHPENZIME 4-3-5
2003	0	0	0	639.103	143.964	495.139
2004	0	0	0	768.839	118.964	649.875
2005	75.692	0	75.692	799.853	345.892	378.269
2006	761.295	289.846	471.449	1.313.991	256.000	586.542
2007	6.809	-200.667	207.476	1.018.098	492.830	317.792
2008	727.339	-89.179	816.518	2.741.201	722.187	1.202.496
2009	339.685	0	339.685	2.726.204	977.959	1.408.561
2010	2.508.585	1.000.000	1.508.585	2.495.842	960.549	26.708
2011	-282.192	-482.343	200.151	2.478.020	1.372.004	905.865
2012	-315.277	-517.657	202.380	2.213.752	899.192	1.112.180
2013	718.592	904.323	-185.731	2.251.381	1.530.235	906.878
2014	149.785	-125.903	275.688	2.496.630	1.028.776	1.192.166
2015	667.671	50.636	617.035	2.687.791	1.163.513	907.243

2016	-25.966	-49.049	23.083	2.557.101	2.115.212	418.806
TOTAL	5.332.018	780.007	4.552.011	27.187.806	12.127.275	10.508.520

Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga: “Raiffeisen Bank”⁵⁰, “Alpha Bank”⁵¹, “Tirana Bank”⁵², “Credins Bank”⁵³, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti⁵⁴.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

i) të ardhurat nga pagat e subjektit në: Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës Parë Tiranë⁵⁵, Shkollën e Magjistraturës⁵⁶, Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë⁵⁷;

ii) të ardhurat nga pagat e bashkëshortes në: “Raiffeisen Bank”⁵⁸, të ardhurat nga leja e lindjes sipas Institutit të Sigurimeve Shoqërore⁵⁹, “Alpha Bank”⁶⁰;

iii) të ardhurat nga interesat bankare⁶¹.

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

i) Shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së NJEF (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT)⁶².

ii) Shpenzimet e udhëtimit, për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi *TIMS*. Për përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si bazë shpenzimet mesatare të udhëtimeve sipas linjave ajrore, duke filluar nga 180 euro për udhëtim, deri në 300 euro për udhëtim për linjat më të gjata. Në rastet kur ka informacion për destinacionet e largëta, shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur duke parë në internet çmimet mesatare të destinacionit përkatës. Ndërsa, për shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 50 euro/ditë shpenzim qëndrimi dhe ushqimi. Në rastet kur është deklaruar qëndrim tek familjarët, shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 20 euro/ditë.

iii) Shpenzimet e arredimit të deklaruara nga subjekti në pyetësorët e dërguar nga Komisioni.

iv) Shpenzimet e interesave për shlyerjen e kredive në “Tirana Bank”⁶³, “Raiffeisen Bank”⁶⁴ dhe “Alpha Bank”⁶⁵.

ç. Vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e shitblerjeve të këtyre pasurive⁶⁶.

⁵⁰ Nr. *** prot., datë 25.1.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

⁵¹ Nr. *** prot., datë 28.1.2019, nga “Alpha Bank”.

⁵² Nr. *** prot., datë 26.2.2019, nga “Tirana Bank”.

⁵³ Nr. *** prot., datë 26.2.2019, nga “Credins Bank”.

⁵⁴ Shihni deklaratimet periodike të çdo viti, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁵ Vërtetim datë 4.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁵⁶ Vërtetim nr. *** prot., datë 21.10.2016, nga Shkolla e Magjistraturës.

⁵⁷ Vërtetim nr. *** prot., datë 20.12.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

⁵⁸ Vërtetim datë 20.10.2016, nga “Raiffeisen Bank”.

⁵⁹ Vërtetim nr. *** prot., datë 25.10.2016, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

⁶⁰ Vërtetim nr. ***, datë 23.1.2017, nga “Alpha Bank”.

⁶¹ Nr. 3480/1 prot., datë 26.2.2019, nga “Tirana Bank”.

⁶² Shihni vendimin nr. 2, datë 22.6.2018, bashkëngjitur tabela për shpenzimet mujore për konsum, në dosjen e Komisionit.

⁶³ Nr. *** prot., datë 26.2.2019, nga “Tirana Bank”.

⁶⁴ Nr. *** prot., datë 25.1.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

⁶⁵ Nr. *** prot., datë 28.1.2019, nga “Alpha Bank”.

⁶⁶ Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme, në dosjen e ILDKPKI-së.

d. Detyrimet financiare (kreditë e marra dhe shlyerjet e principalit), sipas “Tirana Bank”⁶⁷, “Raiffeisen Bank”⁶⁸ dhe “Alpha Bank”⁶⁹.

II.2. KONTROLLI I FIGURËS

DSIK-ja me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, vuri në dispozicion të Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Genti B. Xholi, i deklasifikuar plotësisht me vendim nr. *** , datë 4.10.2019, të KDZH, nga ku rezulton se:

- formulari i deklaramentit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016;
- ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës;
- nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

DSIK-ja, në konkluzion të këtij raporti, ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Genti B. Xholi.

Gjatë hetimit administrativ nuk rezultuan të dhëna të çfarëdo lloji burimi, lidhur me figurën e subjektit të rivlerësimit dhe për këtë arsye, Komisioni vlerësoi se përfundimi i arritur nga DSIK-ja në, lidhje me vlerësimin e figurës së subjektit të rivlerësimit, është i bazuar.

Ne përfundim të procesit, u arrit në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Genti Xholi, është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës.

II.3. VLERËSIMI PROFESIONAL

Në zbatim të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, z. Genti Xholi, bazuar në:

A. Raportin për analizimin e aftësisë profesionale me nr. *** prot., datë 31.10.2019, kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 31.10.2019, nga ku rezultuan gjetjet, si më poshtë:

Për aftësitë profesionale

a. Njohuritë ligjore

b. Për sa i përket vlerësimit në aspektin profesional rezulton se subjekti ka shfaqur aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimit ligjor dhe logjik. Ka marrë pjesë në aktivitete profesionale për ngritjen e nivelit profesional.

c. Arsyetimi ligjor

Bazuar në aktet e dorëzuara dhe në dosjet e shortuara konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokuror Genti Xholi, shfaq aftësi në pasqyrimin e rrethanave të faktit, analizën e provave në përputhje me bazën ligjore të aplikueshme. Aktet e përpiluara prej tij paraqiten të qarta, të plota dhe të kuptueshme. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe niveli i arsyetimit është në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor.

⁶⁷ Nr. *** prot., datë 26.2.2019, nga “Tirana Bank”.

⁶⁸ Nr. *** prot., datë 25.1.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

⁶⁹ Nr. *** prot., datë 28.1.2019, nga “Alpha Bank”.

Për aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Duke pasur parasysh statistikën e ngarkesës së punës, si dhe natyrën e çështjeve që trajtohen në Prokurorinë e Apelit Tiranë, konstatohet se prokurori Genti Xholi, është përballur me një ngarkesë të konsiderueshme pune, si dhe ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës duke kryer detyrat e ngarkuara me efikasitet.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrë funksionale përfaqësimit në gjykim, në Gjykatën e Apelit Tiranë, të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale. Nga shqyrtimi i dosjeve të shortuara rezulton se subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi të mira në organizimin efikas të punës së tij, në përfaqësimin e akuzës në proceset gjyqësore, duke përballuar me cilësi dhe shpejtësi volumin e punës. Për vitet 2014-2016, vlerësimet e Prokurorit të Përgjithshëm kanë qenë në nivelin “shumë mirë”.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i akteve të dorëzuara nga subjekti dhe pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Genti Xholi, në ushtrim të kompetencave të tij ka aftësi për të administruar dosjet.

Për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Genti Xholi, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se ai është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit për etikën profesionale të prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Genti Xholi dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga të tre dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Genti Xholi. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Gjithashtu, asnjë prej tre dokumenteve ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara, nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Për aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në tre dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk rezultojnë të dhëna që flasin për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesëmarrësit në proces, por nga vlerësimet e punës subjekti është vlerësuar “shumë mirë”.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Genti Xholi, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”, në këto vite, mbështetur në treguesit vjetorë të punës.

c) *Gatishmëria për t’u angazhuar*

Ka marrë pjesë në nëntë aktivitete profesionale, si për ngritjen e nivelit profesional, ashtu edhe në shkëmbimin e eksperiencave apo përfaqësimin e institucionit brenda dhe jashtë vendit duke u vlerësuar me certifikatat përkatëse.

B. Informacionin e marrë nga burime të ligjshme, ku si të tilla janë konsideruar:

1. Tre aktet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjet penale të përzgjedhura me short, nga analiza e të cilave, në tre dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe katër dosjet e para të hedhura me short, kanë rezultuar të njëjtat gjetje si në raportin e KLP-së.

Në lidhje me dosjen nr. 5, “konkluzione për vendimin penal nr. ***, datë 22.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, nga aktet⁷⁰ e administruara në këtë dosje u konstatua se:

- Me vendimin për pushimin e çështjes të datës 21.1.2013, prokurori R. T., ka vendosur pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. ***, viti 2013, për veprën penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor në ngarkim të personit nën hetim S. K., duke argumentuar se nga aktet rezultoi e provuar që aksidenti me pasojë vdekjen e shtetasit A. Ç., ka ardhur si rezultat i shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor nga vetë viktima.

- Me vendimin nr. ***, datë 22.7.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndër të tjera, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkueses F. Ç., me objekt: “Kundërshtim të vendimit të pushimit të çështjes nr. ***, datë 21.1.2013, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, si të pabazuar në ligj.

- Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuessa, e cila kërkon ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pranimin e kërkesës për prishjen e vendimit të pushimit të procedimit penal, si dhe dërgimin e çështjes për hetime të mëtejshme në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në ankimin e saj shtetasja F. Ç., referon se: “Në urdhrin e prokurorit për kryerjen e veprimeve hetimore, është përcaktuar veprimi hetimor “të kërkohet, sekuestrohet dhe administrohet CD-ja me pamjet filmike të aksidentit të ndodhur”. Nga dosja penale nuk rezulton të jetë kërkuar, sekuestruar apo administruar CD-ja me pamjet filmike të aksidentit të ndodhur ku ka gjetur vdekjen shtetasi A. Ç. Për këtë detyrë organi i akuzës nuk ka kryer asnjë veprim procedural për të vërtetuar se si ka ndodhur ngjarja, por vetëm mjaftohet me thënien se nuk ka prova, të cilat duhet të kërkoheshin me shkresa zyrtare”.

- Çështja në Gjykatën e Apelit Tiranë, është përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili në datën 6.2.2014, ka parashtruar konkluzionet përfundimtare në lidhje me vendimin nr. ***, datë 22.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe çmon se: (i) ankuesit nuk sjellin asnjë argument në lidhje me faktin dhe rrethanat e trajtuara në aktin ekzistues të cilat mund të rivlerësoheshin; (ii) saktësia e aktit të ekspertimit nuk është vënë asnjëherë në diskutim gjatë hetimit të çështjes; (iii) hetimet janë kryer të plota; dhe (iv) ankuesi parashtron vetëm pretendime, të pabazuara në ndonjë argument shkencor, për të vënë në dyshim konkluzionet e aktit të ekspertimit. Për këto arsye subjekti Genti Xholi, ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit penal nr. ***, datë 22.7.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Me vendimin nr. ***, datë 28.2.2013, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesës, prishjen e vendimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë “Për

⁷⁰ Shihni aktet e dosjes nr. 5 dërguar nga KLP-ja.

*pushimin e çështjes penale nr. ***, viti 2013” dhe vazhdimin e hetimeve, duke vlerësuar se organi i akuzës duhet të rikonsiderojë urdhrin lidhur me CD me pamjet filmike, nëse mund të rikuperohen si dhe të pyesë shtetasin B. Ç., që të shpjegojë lidhur me pretendimet e tij, se viktima po lëvizte me motor në momentin e aksidentit.*

Në analizë të fakteve dhe dokumenteve si më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, duket se në konkluzionet përpara Gjykatës së Apelit Tiranë, subjekti i rivlerësimit në mos përmbushje të detyrës si prokuror i apelit, nuk ka trajtuar pretendimet e kërkuases, znj. F. Ç., duke vlerësuar pa asnjë arsytim se: (i) hetimet në shkallë të parë janë kryer të plota; dhe (ii) ankuesit nuk sjellin asnjë argument në lidhje me faktin dhe rrethanat e trajtuara në aktin ekzistues, gjë që bie në kundërshtim me faktet konkrete.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit, lidhur me këtë konstatim, i janë kërkuar sqarime subjektit, i cili në parashtimet e tij të datës 24.11.2019, ka sqaruar se arsytimi në konkluzionet e paraqitura, ku ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit, bazohet në interpretimin e aktit të ekspertimit automobilistik, duke vlerësuar se, qartësisht në këtë akt provohet mekanizmi i ngjarjes. Sipas subjektit, konkluzionet e arritura janë konfirmuar nga rihetimi i çështjes. Subjekti ka vënë në dispozicion vendimin për pushimin e procedimit penal nr. ***/2013, datë 1.9.2014, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të marrë pas prishjes së vendimit të mëparshëm të pushimit nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe vendimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pushimin e procedimit penal nr. ***/2013, datë 1.9.2014, konstatoi se:

Së pari: pas prishjes së vendimit të pushimit të çështjes nga ana e prokurorisë, janë kryer disa veprime hetimore shtesë: (1) pyetja e bashkëshortes së viktimës, znj. F. Ç.; (2) pyetja e vëllait të viktimës, z. B. Ç.; (3) kryerja e një riekspertimi autoteknik nga një grup ekspertësh, prej të cilit rezultoi se, aksidenti nuk mund të shmangej nga drejtuesi i mjetit, çka dëshmoi se në ndryshim nga konkluzionet e subjektit të rivlerësimit, hetimet në shkallë të parë nuk ishin kryer të plota.

Së dyti: lidhur me pretendimin për moskryerjen e veprimit hetimor të sekuestrimit apo administrimit të CD-së me pamjet filmike të aksidentit të ndodhur, subjekti në parashtimet e tij, nuk ka dhënë shpjegime, por i pyetur në seancën dëgjimore, ai deklaroi se: *“.... ne duke qenë se jemi prokurori apeli, nuk kryejmë proces hetimor. Ky proces hetimor mbasi mbaron në Gjykatën e Apelit, kthehet në Gjykatën e Shkallës së Parë, ku prokurori i shkallës së parë ka detyrimin që të ekzekutojë dhe të zbatojë vendimet, detyrimet e gjykatës. Dhe unë e kam konstatuar këtë fakt, sepse unë ju kam vënë dhe në dispozicion dhe vendimin e prokurorit.... Ngjarjen e kemi të prejardhur dhe për sa i përket CD, shoh që në dosje nuk është administruar për shkak të kalimit të një kohe jashtëzakonisht të gjatë. Pra, ngjarja në janar të vitit 2017, është mbaruar në shtator të 2017 në apel dhe më pas është rikthyer përsëri në shkallë të parë, për të rifilluar hetimet, procedurë që nuk i takon më prokurorit të apelit ...”.*

Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes në fjalë, Komisioni konstatoi se gjatë përpilimit të konkluzioneve përfundimtare nga subjekti i rivlerësimit, ka pasur vend për një vlerësim më të hollësishëm të pretendimeve të kërkuases, si dhe veprimeve të kryera nga prokurori i shkallës së parë. Por, në vlerësimin tërësor të çështjes, nisur nga konstatimet dhe vlerësimet pozitive në drejtim të aftësive profesionale të subjektit, si dhe, duke iu referuar vendimit Nr. ***/2017, të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit: *“Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe që tregojnë mungesë të aftësive profesionale”*, trupi gjykues vlerësoi se, konstatimi në lidhje me këtë çështje, nuk cënon aftësitë profesionale si dhe besimin të publikut, për subjektin e rivlerësimit.

2. Tre denoncime nga publiku të administruara në Komision, si vijojnë:

- Denoncim nga shtetasi A. A.,⁷¹
- Denoncim nga shtetasi H. R.,⁷²
- Denoncim nga shtetasi N. C.,⁷³

nga përmbajtja të cilave, konstatohet se pretendimet e denoncuesit, lidhen me vendimmarrjen e prokurorëve të çështjeve, për të cilat, bazuar pikën 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk është në kompetencën e Komisionit, të gjykojë mbi korrektesinë e vendimit dhe themelit të çështjes. Gjithashtu, në keto denoncime, nuk referohen shkelje konkrete në drejtim të aftësive profesionale të subjektit Genti Xholi, apo ndonjë provë për korrupsion prej tij, sipas nenit 53 të ligjit 84/2016.

3. Informacioni i marrë nga KLP-ja, në lidhje me ankesa dhe procedime disiplinore të subjektit të rivlerësimit, nuk rezultuan masa disiplinore.

C. Rivlerësimi profesional sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, rezultoi se:

- Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale, sipas nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative, sipas nenit 74, të ligjit nr. 96/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76, të ligjit nr. 96/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, parashikuar nga neni 75, i ligjit nr. 96/2016.

Në përfundim, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, pas propozimit të relatores së çështjes, është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave, si dhe është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë gjatë seancës dëgjimore, ku subjekti ishte prezent, i përfaqësuar personalisht.

Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi i është përgjigjur me korrektesë brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë në mënyrë shteruese informacionin e kërkuar, gje që është mbajtur në konsideratë në marrjen e vendimit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.

IV. SEANCA DËGJIMORE

⁷¹ Shihni 2 denoncime nga shtetasi A. A., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 19.1.2018, dhe protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 18.9.2019, në dosjen e Komisionit.

⁷² Shihni kallëzim penal nga H. R., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 29.8.2019, në dosjen e Komisionit.

⁷³ Shihni denoncim nga N. C., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 25.8.2018, në dosjen e Komisionit.

Në datën 5.12.2019, sipas nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore, për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Genti Xholi, gjatë së cilës kërkoi konfirmimin në detyrë.

Trupi gjykues i Komisionit nisur nga rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me pasurinë, figurën dhe aftësitë profesionale, vlerësoi se procesi i vendimmarrjes në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Genti Xholi, duhet të bazohet në vlerësimin tërësor të tri kritereve, referuar pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues i Komisionit, në përfundim të seancës dëgjimore, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionere Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, dëgjoji subjektin, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, dhe pasi administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, Genti Xholi, dhe shpalli këtë vendim, në datën 10.12.2019, sipas pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

V. KONKLuzion Përfundimtar

1. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Genti Xholi, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit;
2. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Genti Xholi, ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, sipas nenit 59/b të ligjit;
3. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Genti Xholi, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59/c të ligjit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi kreu bisedimet për marrjen e vendimit në praninë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë:

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Genti Xholi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 10.12.2019.

ANTËTARËT E TRUPIT GJYKUES

**KRYESUES
Roland ILIA**

**ANËTAR/RELATOR
Firdes SHULI**

**ANËTAR
Etleda ÇIFTJA**

*Sekretare gjyqësore
Anisa Duka*